



D R I T A

“Drita lufton kundër errësirës kur ndriçon.”

KEPLER

E PËRMUAJSHME FETARE - KULTURORE E KISHËS KATOLIKE

Prizren • Shtator 2008 • Viti XXV • Nr. 9 (167) • Çmimi: Kosovë 1€, Europë 2€, Zvicër 3SFR, SHBA \$2.50



SHENJËTORJA E ZOJËS NË LETNICË – VEND FEJE E BASHKIMI E KREMTJA E ZOJËS MADHE

FAQE 2

(Shkruan: DON AGIM QERKINI)



KATEKEZA – DETYRË E MBARË KISHËS KATOLIKE

FAQE 6-7

(Shkruan: DR. DON LUSH GJERGJI)

SHTEGTIMI I PAPËS BENEDIKTIT XVI NË TOKËN FRANCEZE KA PUSHTUAR ZEMRËN DHE MENDJEN E FRANCEZËVE

FAQE 11-12

(Shkruan: DON ANTON UKAJ)



■ KËNDVËSHTRIM

Edhe një fillim i vështirë i vitit shkollor

■ SHKRUAN:

Dr. Marjan Dema, prorektor i UP

Sistemi i edukimit dhe arsimit është themeluar të ofrojë edukim dhe trajnim kryesisht për fëmijë dhe të rinj. Ky sistem është i konstruktuar që subjekti (nxënësi dhe studenti) të arrijë të mësojë materien, e cila i dedikohet atij përmes kurikulave të lëndëve të ndryshme. Në këtë kuadër, shumë vende të botës tashmë e kanë të obliguar jo vetëm shkollimin fillor, por edhe atë të mesëm. Ky fakt flet mjaft, se sa i rëndësishëm është arsimit për një shoqëri në përgjithësi dhe për Kosovën në veçanti, sepse Kosova ka një përqindje të madhe të fëmijëve dhe të rinjve në gjirin e vet.

Jemi në fillim edhe të një viti të ri shkollor në të gjitha nivelet e arsimit në Kosovë. Këto ditë shumë fëmijë, tinxherë dhe studentë ia mësnyne dyerve të shkollave dhe të universiteteve në Kosovë. Ata e fillojnë këtë aktivitet me një shpresë të madhe se do të nxënë shumë njohuri dhe do të bëhen ekspertë të mirë në lëmi të ndryshme. Të gjithë janë të bindur se një ditë këtotribute do t'i shfrytëzojnë për një jetë më të mirë dhe një kontribut më të madh për Kosovën e tyre të dashur. Por, ata që në fillim do të ballafaqohen me të njëjtat probleme që i shoqërojnë me vite të tëra, mungesa e kuadrit të kualifikuar për disa lëmi të caktuara, mungesa e hapësirës shkollore, mungesa e pajisjeve laboratorike etj. Të gjitha këto nuk do të paraqiteshin ndonjë problem shumë të madh sikur të ekzistonte vullneti i kuadrit mësimor për punë dhe përkushtim që edhe në këto kushte të arrihet një optimum i kërkuar nga ta.

Kosova ka një popullatë shumë të re. Mbi 25% e popullatës është e angazhuar në këtë sferë me rëndësi vitale për Kosovën. Gjithmonë flet, qahen hallet e arsimit, por ka shumë vështirësi të gjendet një formulë adekuate, e cila do të kishte garantuar një shpresë për një edukim dhe arsimim më cilësor. Me një investim të qëlluar, me një qasje të drejtë, me angazhim adekuat, sipas një planifikimi afatgjatë, Kosova do ta ndryshonte pasqyrën e vet në të gjitha sferat, ekonomike, politike, shoqërore, edukative etj. Pra, pa një arsim të mirëfilltë nuk ka ndryshim në jetën kosovare. Jemi duke jetuar në një shekull ku përgatitja e mirë shkollore do të ndihmojë në afrimin me botën progresive. Kemi humbur shumë kohë në këtë aspekt jo gjithmonë me fajin tonë. Është krijuar një distancë e madhe në të gjitha aspektet ndërmjet Kosovës dhe shteteve tjera. Nuk ka zhvillim as avancim në asnjë lëmi të jetës në përgjithësi pa një arsim substancialisht më të avancuar. Duhet kontroll më i madh i kuadrit mësimor dhe përgjegjësi e plotë për stafin drejtues të arsimit në të gjitha nivelet, që të arrihen objektivat tona në sferën e arsimit. Me një koordinim më të mirë, rezultatet do të jenë më të favorshme. Niveli i suksesit në mësimnxënie ka rënë, ndërsa dëshira për diploma është në rritje të vazhdueshme. Niveli jo i kënaqshëm i arsimit në përgjithësi do të ndikojë në mënyrë të drejtpërdrejtë në të gjitha sferat e jetës kosovare.

Kosova ka një rini të shkëlqyeshme. Tërë Evropa na e ka lakmi për një thesar të tillë. Kjo rini e dha provimin e vet gjatë historisë së dhimbshme të saj. Ajo sakrifikoi shumë për këto ditë që ne po i gëzojmë. Duhet kushtuar kujdes kësaj pjese të popullit tonë, duke i ofruar një arsim më të mirë dhe në këtë mënyrë do t'i ofrojmë perspektivë më të ndritshme. Duke i kushtuar kujdes arsimit, sigurojmë një të ardhme të shkëlqyer për tërë popullin e Kosovës. Nuk ka nevojë për ndonjë investim të madh. Ka nevojë për një planifikim afatgjatë duke e pasur në qendër arsimin e jo interesat e çfarëdo natyre qofshin ato. Me një angazhim më të madh, edhe në këto kushte mund të arrihen më shumë rezultate. →



Etosi i Pleqnisë

Atë Shtjefën Gjeçovi: “Libri i njimbndhetët Kanuni i Pleqnisë”

FAQE 16-17

Shkruan: Prend BUZHALA

Intervista me Mark Krasniqin

Kisha katolike ka pasur njerëz të mëdhenj nga radhët e klerit në të gjitha fushat (II)

FAQE 12-13



Shenjtërorja e Zojës në Letnicë – Vend feje e bashkimi E Kremtja e Zojës Madhe

Letnicë, 15 gusht 2008. E Kremtja e Zojës Madhe në Letnicë, si çdo vit edhe sivjet u kremtua me shumë solemnitet. Padyshim, kjo shenjtërore jona në Letnicë është vendi në të cilin bashkohen njerëzit e feve, gjuhëve dhe kombeve të ndryshme për t'iu lutur të njëjtës Nënë Qiellore, Zojës së bekuar.

Këtij kremtimi solemn i parapriu nëntëditëshi kushuar Zojës, me ç'rast besimtarët patën mundësinë të përgatiten sa më mirë për festë.

Tradicionalisht, me rastin e kësaj të kremteje të madhe, në Letnicë kanë shtegtuar ipeshkvij, meshtarë, motra të nderit e shumë besimtarë, duke lutur me devocion Zojën e Bekuar dhe duke kërkuar ndërmjetësinë e saj për nevojat e ndryshme.

Këtë vit, ipeshkvi ynë Imzot Dodë Gjergji, në përcjellje të ipeshkvit të Sapës (Shqipëri) Imzot Lucjan Avgustini,

meshtarëve, motrave dhe shumë besimtarëve, natën e festës, më 14 gusht shtegtoi këmbë nga Vitia, saktësisht prej kishës së Zembrës Krishtit në Viti deri në Letnicë. Njëti i ipeshkvit ishte në shenjë falënderimi Shën Palit për ungjillëzimin e popullit tonë.

Meshën solemne, në vigjilje të këtij kremtimi, në bashkëmesim me shumë meshtarë, e udhëhoqi arqipeshkvi i Tivarit Imzot Zef Gashi, i cili në pretkun e rastit theksoi rolin e Zojës së Bekuar në jetën tonë të krishterë.

Ajo që i jep bukurri festive kësaj nate, padyshim është procesioni në fund të Meshës. Besimtarët me qirinj në dorë, të bashkuar dhe një zemre i këndojnë këngë e himne lavdi Zojës Bekuar.

Të nesërmen, ditën e të Kremtes së Zojës, meshën e udhëhoqi ipeshkvi ynë Imzot Dodë Gjergji. Bashkëmesoi arqipeshkvi Imzot Zef Gashi me shumë meshtarë të

tjerë. Në këtë ditë të madhe, është bërë traditë të shtegtojnë edhe shumë ushtarë të trupave të KFOR-it, të cilët të prirë nga kapelanët dhe gjeneralët ushtarakë, vijnë për të marrë pjesë në Meshën shenjte.

Ipeshkvi në pretkun e rastit, ndër tjera theksoi rëndësinë e lutjes dhe guximit që duhet ta dëshmojmë para botës, dhe kështu të bëhemi bartës të Lajmit të Gëzueshëm. 'Jeta duhet bazuar në drejtësi që të ketë paqe për të gjithë'. Në vazhdim u përqendrua kryesisht në Vitin e Shën Palit, të cilin Papa Benedikti XVI e shpalli këtë vit, duke theksuar se të gjithë jemi të thirrur ta predikojmë dhe dëshmojmë Ungjillin në përditsh-mërinë tonë.

Edhe ditën e festës, procesioni ishte me truporën e Zojës Bekuar, dhe më pas festimi u përmbyll me bekimin solemn. (Don Agim Qerkin)



Gjatë kremtimit të meshës në Letnicë



Ndarja e Kungjit të Shenjtë

(vijuar nga ballina)

Pritjet për një përfundim të kësaj gjendjeje në arsim, po zbehen me kalimin e kohës. Për krizën në arsim është krijuar bindja se do të zgjasë më shumë, përkundër premtimeve të shumta të faktorëve relevantë politikë, se do ta ndryshojnë gjendjen aktuale. Nuk duhet pritur vetëm nga politika që të marrë iniciativa. Armata e tërë, e përfshirë në arsim, duhet të angazhohet me shembullin e vet në vendin e vet të punës që në këto kushte të arrihet që të ndryshohet ky realitet. Ata duhet të krijojnë ambiente të përshatshme për konkurrencë në mësim ndërmjet nxënësve dhe studentëve dhe konkurrencë ndërmjet kuadrit mësimor për rezultate në punë. Kuadri mësimor duhet më tepër të fokusohet në zbatimin e njohurive të reja në praktikë, pra të orientohemi kah mësimi përëndimor dhe të largohemi nga mënyra teorike e mësimi që e patëm "dhuratë" nga lindja. Të krijohet një ambient ku papunëtori të mos ketë vend në arsimin tonë. Janë këto kërkesa që i kemi në duart tona. Këto kërkesa nuk kërkojnë investime, nuk kërkojnë kohë shtesë, por vetëm një kujdes të shtuar dhe rezultatet do të jenë të garantuara. Por e mban shpresa këtë popull, se me një përkushtim më të madh të të gjithë faktorëve relevantë të sferës së arsimit dhe më gjerë, gjendja do të ndryshojë për të mirë dhe efektet pozitive do të duken në horizontin e këtij nënqielli.

Don Viktor Sopi kremtoi – 25 vjetorin e shugurimit meshtarak

9 gusht 2008. Në një atmosferë familjare dhe kishtarë në mënyrë shumë dinjitoze, në Binçë – Viti, është kremtuar 25-vjetori i shugurimit meshtarak i don Viktor Sopi, famullitarit të Ferizajt dhe drejtorit të Caritas-it të Kosovës.

Në këtë manifestim kishtar morën pjesë dy ipeshkvij, afër 40 meshtarë, shumë motra të nderit si dhe qindra besimtarë të kësaj ane të Anamoravës. Mesha solemne është kremtuar në Binçë, kurse dreka vëllazërore në Viti. Drekën e ka shtuar familja e don Viktorit, nën përkujdesjen e motrave Bijat e Dashurisë Hyjnore.

Në oborrin e kishës së Binçës, ku kësaj radhe veçmas ishte dekoruar bina dhe elteri nga motrat e vendit, është kremtuar mesha solemne. Meshën e shenjtë e ka udhëhequr don Viktori në bashkëmesim me shumë meshtarë (pothuajë nga gjitha famullitë e Kosovës). Në falën e rastit, mons Damjan Kurti, që kishte ardhur nga Durrësi për këtë jubile të don Viktorit, ka folur mbi rëndësinë e misionit meshtarak, duke vënë në pah vendosmërinë, talentin, vulltin dhe frytet e punës së don Viktorit në këtë mision.

Mons Damjani në mënyrë të veçantë ka spikatur vepërën dhe eksperiencën shpirtërore të shën Terezës së Avilës si frymëzim të jetës meshtarake. Ai nuk harroi të përmendë as kontributin e pazvendësueshëm të familjes së don

Viktorit, që nga martirët e shekullit 19, dhe posaçë rolin e gjyshit të tij, Gjonit, përkujdesjen e tij për Kishën (duke i falur pronat të veta famullisë) me kompenzime materiale dhe shpirtërore që ai ia ka bërë Kishës. Krejt në përfundim, don Viktori i falënderoi të gjithë ata që në çfarëdo mënyre e kishin përkrahur në rrugën e tij jetësore dhe meshtarake, si dhe ata që në mënyrë ma të veçantë i kontribuan këtij manifestimi dinjitoz. Urojme që t'i punojë shëndeti dhe të vazhdojë edhe për shumë vite dhe dekada puna e frytshme e meshtarit tonë don Viktor Sopi. (Redaksia)



U kremtua Zoja e Hasit në Zym

Zym, 15 gusht 2008. E Kremtja e Zojës së Madhe u festua me solemnitete edhe në familjinë e Zymit. Në këtë ditë të bekuar për mbarë Kishën, Zoja e Bekuar është ajo që bashkon njerëzit në lutje.

Kësaj të kremteje i parapriu përgatitja shpirtërore e besimtarëve, të cilët përherë dëshmojnë një përkushtim të madh dhe nderim ndaj të quajturës "Zoja e Hasit". Meshën e Vigjiljes e udhëhoqi don Franë Kola, delegat i Administraturës Apostolike të Prizrenit, ndërsa, ditën e Zojës së Madhe, më 15 gusht 2008, si përherë, Meshës i parapriu procesioni me truporën e Zojës Bekuar, ndërsa meshën e shenjtë e udhëhoqi Mons. Luçjan Avgustini në bashkëmshim me shumë meshtarë.

Mons. Luçjani në pretkun e tij të rastit, ndër tjera, theksoi rëndësinë e lutjes së rruzarës në familje tona. Ai përmendi edhe faktin se pikërisht para 19 viteve, më 15 gusht 1989, ai dhe ipeshkvi i tanishëm i Kosovës Imzot Dodë Gjergji, në Zym u shuguruan meshtarë nga duart e të ndjerit, ipeshkvit Imzot Nikë Prela.

Kremtimin e kësaj të kremteje të madhe e përmbylli administratori i kësaj familje, Dr. Don Shan Zefi, i cili falënderoi Shkelqësinë e tij Imzot Luçjanin dhe gjithë të tjerët për pjesëmarrje në feste, duke i uruar dhe porositur në ndërmjetësinë e Zojës së Hasit. (Don Agim Qerkinj)



Mons. Luciani në bashkëmshim me meshtarët

Lajmet shkurt

Festa e Shën Rrokut në Novosellë

16 gusht 2008. Sikur çdo vit, po ashtu edhe sivjet në familjinë e Novosellës është kremtuar Festa e Shën Rrokut, pajtorit të famullisë sonë. Festës i parapriu përgatitja shpirtërore prej tri ditësh.

Dita e festës së Shën Rrokut, ishte një ditë e bukur me një freski të veçantë për muajin gusht.

Oborrin e Kishës e kishin vërshuar një numër i madh i besimtarëve, jo vetëm të famullisë sonë, por edhe nga famulli dhe vende të tjera të Kosovës.

Meshën solemne në orën 11:00 e udhëhoqi don Albert Demaj, i cili për disa vite ishte kapelan në familjinë tonë dhe tani është famullitar në familjinë e Binçës.

Në bashkëmshim me Don Albertin ishin edhe një numër i madh i meshtarëve, të cilët e madhështuan edhe më shumë festën.

Në pretkun e rastit don Alberti foli mbi jetën dhe veprën e Shën Rrokut. Jeta e tij, siç theksoi predikatori, ishte me shumë vuajtje, fljime dhe sakrificë, që janë



njëkohësisht ftesë për të gjithë ne, që në shembullin e tij, të gjejmë forcën shpirtërore për t'u ballafaquar me të gjitha sfidat, kryqet dhe sakrificat e jetës. Ai theksoi se sot gjendet në një situatë krejt ndryshe në krahasim me atë, deri sa shërbente në këtë famulli, sepse ishte koha e luftës së fundit në Kosovë. Po ashtu ai foli edhe mbi rëndësinë e familjes dhe të edukatës së fëmijëve, që është bazë dhe fundament për shoqërinë dhe shtetin.

Në fund të meshës shejte, famullitari i Novosellës don Lush Sopi, së pari e falënderoi Zotin për këtë ditë të bukur, pastaj i falënderoi pjesëmarrësit në meshë dhe don Albertin për fjalët e bukura që i drejtoi gjatë pretkut. Po ashtu i falënderoi edhe vëllezërit meshtarë dhe motrat e nderit, kurse një falenderim të veçantë ia bëri edhe Korrit të famullisë, të cilët me këngët e tyre e madhështuan edhe më shumë Meshën Shejte. (Jeton Jakaj)

Kisha përkujton figurën e Nënës Terezë

5 shtator 2008. Në kuadër të manifestimeve "Ditët e Nënës Terezë" më 5 shtator 2008, ipeshkvia e Kosovës në fshatin Dugajevë të Klinës kishte organizuar një meshë përkujtimi dhe falënderimi për figurën e madhërishte të kishës dhe të kombit, të lumturës Nënës Terezë. Meshën e udhëhoqi Ipeshkvi i Kosovës mons. Dodë Gjergji. Në këtë kremtim eukaristik koncelebruan edhe një numër vëllezërish meshtarë nga e gjithë ipeshkvia. Kësaj meshe solemnitetin ia kishin shtuar edhe prania e motrave të Nënës Terezë, të cilat ipeshkvi i falënderoi nga zemra. Në meshë, në atmosferën e një dielli përcëllues, morën pjesë edhe një numër i madh besimtarësh nga famullitë e ndryshme anekënd Kosovës, të cilët kësaj feste ia kishin shtuar madhësitë e saj. Për të qenë të informuar sa më mirë besimtarët e ipeshkvisë sonë për këtë solemnitete, po shkëpusim sekuenca nga predikimi i ipeshkvit tonë



Dodë Gjergjit, i cili u shpreh kështu për figurën e Nënës Terezë:

"Nënë Tereza nuk dinte që vetëm ndihmën ta barte tek njeriu, por dinte që se bashku me një copë bukë të bartte në ta edhe një copë zemër e dhimbje për vuajtjet që përjetonte. Ta falënderojmë Zotin që e kishim. Nënë Terezë është shembulli më i mirë se si dashurohet Zoti me gjithë zemër. Nuk mundet bota me e pa Zotin nëse në tokë nuk ka pishtarë, të cilët Zoti na i shfaqti e dërgoi. Bota nuk mundet për ta dashur Zotin nëse nuk e ka shembullin e Nënës Terezë, një kripë e cila e bën shpirtin tonë të pa prishur".

Ky rast ishte një gëzim i madh sidomos për dugajevasit që ta kremtojnë këtë festë në praninë e ipeshkvit. Gjithashtu shumë mirënjohës ishte edhe administratori i kësaj familje, don Herbert Berisha. Ipeshkvi në fund besimtarëve dhe të pranishmëve ua përcolli edhe përgëzimet në emër të famullitarit të dikurshëm don Gjergji Gjergjit. (Wilson Culaq)

Bekimi i menzës për të varfër

20 shtator 2008. Duke marrë para sysh gjëndjen e vështirë ekonomike dhe rastet e shumta sociale në vendin tonë, ipeshkvi i Kosovës, Imzot Dodë Gjergji, me të ardhur në Kosovë si prijës i Kishës këtu, pati ndërmarrë një iniciativë humane për t'u dalë në ndihmë të varfërve. Qëllimi i tij ishte të realizoj një kuzhinë popullore në të cilën do të kenë mundësinë të ushqehen të varfërit, apo edhe të vetmuarit e sëmurë e për të cilët s'ka kush të kujdeset.

Kjo iniciativë është mbështetur nga të gjithë e veçmas nga Caritasi i Kosovës dhe motrat e nderit, të cilat edhe ashtu janë në shërbim sidomos të të varfërve. Duhet veçuar angazhimin e motrave Vinçenciane të cilat angazhuan edhe një motër të tyre për të punuar dhe udhëhequr me këtë kuzhinë.

Falë Zotit, bamirësve dhe angazhimit personal të



Mons. Doda duke bashkëndarë ushqimin me të varfërit



Ipeshkvi duke bekuar menzë

ipeshkvit, ky projekt u realizua pranë kishës së Shna Ndout në Prishtinë, dhe më 20 shtator 2008, ipeshkvi, në prani të meshtarëve, motrave dhe mysafirëve tjerë e bëri bekimin e saj. Ndër tjera, në fjalët e rastit ipeshkvi uroi që kjo menzë të jetë një strehë për njerëzit e varfër,

të cilët së paku do të kenë mundësi të marrin nga një shujtë të ngrohtë.

Pas bekimit, ipeshkvi dhe pjesëmarrësit tjerë, ndër ta edhe të varfër nga Prishtina me rrethinë, shijuan drekën e parë në këtë kuzhinë. (Redaksia)

Lajmet shkurt

Seminari i mbajtur në famullinë e Binçës

9-13 shtator 2008. U mbajt një seminar përshpirtërie nga Don Prekë Lazri, meshtari ynë dhe drejtori i Radio Marisë në Shqipëri. Seminari zgjoi interesim të madh tek besimtarët tanë dhe u ndoq nga më shumë se 200 besimtarë të të gjitha moshave, fëmijë, të rinj dhe pleq. Don Preka, si një predikatar me përvojë, bukur, thjeshtë dhe në mënyrë shumë bindëse, i shpjegonte të vërtetat e fesë sonë. Ai gjatë këtyre ditëve arriti në ne ta zgjonte dhe thellonte shumë më tepër besimin në Zotin. Don Preka me fjalë dhe me shembuj nga jeta e përditshme, arriti të na nxisë t'i harrojmë të gjitha të këqijat, vuajtjet, urrejtjet, paragjykimet e rrethit, dhe secili të gjejë në zemrën e vet dritën e dashurisë e ta fillojë një jetë të re me Zotin. Vërtet deri më tani ishte kjo një përvojë e papërtjetuar për ne si besimtarë. Mu pse ishte shumë interesante për të gjithë, për punëtorë e për nxënës, seminari u mbajt në mbrëmje nga ora 18 deri në 22, kur fillonte mesha. Përveç ligjëratave të bukura e kuptimplotë, ne kemi pasur mundësi edhe të diskutojmë për shumë probleme dhe t'i bëjmë luftime spontane, ta falënderojmë Zotin e ta kuptojmë më mirë se kurrë dashuri-



në e pafund e të mrekullueshme që Zoti ka për ne. Falënderojmë Zotin që përmes fjalëve të mrekullueshme të Don Prekës fituam qetësinë që hap derën e lumturisë e që është jeta me Zotin. U ndamë me shpresë e dëshirë që të takohemi edhe vitin tjetër në një seminar të tillë aq frytdhënës për të gjithë. (Klodina Gasbi)

Në Bec dhe Gurakoc u kremtua ditëlindja e Zojës

8 shtator 2008. Në famullinë e Becit u kremtua ditëlindja e Zojës, që njëherit është pajtorja e kësaj famullie. Në krahasim me vitet e kaluara, në këtë vit kjo festë u kremtua me datë dhe jo të dielën para, sikur kremtohej më parë. Shumë famulli të rrethit të Gjakovës, ndër ato edhe famullia e Becit, ka vendosur që festën ta kremtojnë me datë. Dhe kjo është akoma e përshtatshme për ambientin tonë në Kosovë, ku ritmi i jetës dhe i punës është më i ngadalshëm dhe e lejon një gjë të tillë. Në këtë festë morën pjesë shumë besimtarë nga famullia dhe nga i gjithë rrethi i Gjakovës dhe më gjerë. Të pranishëm ishin edhe një numër i madh i meshtarëve. Qendra e këtij festimi ishte kremtimi eukaristik, të cilin e udhëhoqi famullitari i famullisë së shën Pjetrit e Palit në Gjakovë dhe gardiani i bashkësisë françeskanë patër Anton Nua. Ai në fjalën e predikimit theksoi rolin e madh të Zojës së Bekuar, si Nënë e të gjithëve. Ndër të tjera i ftoi besimtarët që gjithmonë në jetën e tyre shpirtërore ta pranojnë Zojën e bekuar si nënë dhe si mësuese të jetës së tyre. Famullitari i kësaj famullie don Kelmend Spaqi, në fund të meshës I falënderoi të gjithë të pranishmit dhe besimtarëve të famullisë ua shprehu urimet për këtë festë. Pas kremtimit eukaristik don Kelmendi shtroi edhe një tryezë vëllazërore për të gjithë të ftuarit.

Kjo festë me solemnitë të madh u kremtua edhe në filialën e famullisë së Zllokuqanit në Gurakoc. Atje meshën kryesore e udhëhoqi don Rrok Gjonlleshaj. Të pranishëm ishin edhe një numër i konsiderueshëm i meshtarëve e sidomos atyre të dekanatit të Pejës. Falënderimet

dhe urimet i shprehu famullitari i ri don Isak Dodës. Edhe në këtë filialë të vogël mbretëroi një klimë e mirë festive. (Redaksia)

Festa e Shën Kryqit u festua në famullinë e Gllaviqicës

14 shtator 2008. Edhe pse ditë e diel, mbledhi në fshatin e komunës së Pejës, në Gllaviqicë, një numër të madh të meshtarëve, intelektualë dhe veprimtarë në sferat e ndryshme të jetës dhe shumë besimtarë të devotshëm ndaj pajtorit të kësaj famullie shna Kryqës, apo Ngadhënjimit të Kryqit. Mesha solemne u kremtua në orën 11, të cilën e udhëhoqi don Albert Demaj, famullitari i Binçës. Ndër të pranishmit po veçojmë kryetarin e Partisë Demokratiane të Kosovës z. Ton Markaj. Me një entuziazëm të jashtëzakonshëm të pranishmit i përshëndeti administratori i famullisë don Herbert Berisha, cili ishte munduar që së bashku me motrat dhe vullnetarët e famullisë, ta përgatisë sa më mirë këtë festë. Si edhe në të kremtet e tjera, për të ftuarit u shtrua sofrat vëllazërore dhe shumica e shtegtarëve gjetën mikëprirjen e vendasve. Por për të gjithë ishte një ditë feste e dhe gëzimi! (Redaksia)



Kisha Katolike “Zoja Pajtores e Shqiptarëve” në Michigan kremton Festivalin e Lirisë 2008

Kur Kosova kreshnike ishte Knën thundrën e tmerrshme dhe gjakpërse të Serbisë, dhe nëna Shqipëri gjithnjë fshante nën sundimin diktatorial e famëkeq të Enver Hoxhës; kur shqiptarët e shkretë dashtë e pa dashtë, ishin të shpërndarë nëpër botë, sikur tufa që i bie ujku; bashkësia katolike shqiptare në Beverly Hills, Michigan, nën drejtimin e të paharueshmit dom Prenk Ndrevashaj, organizoi për të parën herë festivalin e parë gjithëshqiptar në Michigan. Liria dhe Pavarësia ishin dhe mbetën qëllimet dhe ëndërrimet e pandërrueshme dhe të pamohueshme të njeriut shqiptar, si në mërgim e, po ashtu, edhe në trojet etnike dhe në atdhe.

Në fillim ky manifestim nuk ishte i madh për nga numri i pjesëmarrësve, por ishte tejet i rëndësishëm dhe gërthelëm për aktivitet e tjera të shëndosha kombëtare dhe fetare që sensibilizonin çështjen shqiptare në Amerikë dhe anë e mbanë botës. Ky manifestim gjithëshqiptar u emërua “Albanian American Freedom Festival” (Festivali shqiptaro Amerikan i Lirisë) duke përfshirë shqiptarët në mërgim dhe brenda trojeve etnike dhe botën mbarë, se edhe shqiptarët dëshirojnë, ëndërrojnë, se ata janë të betuar në luftë për liri e pavarësi.

I ndjeri don Prenk Ndrevashaj, së bashku me përkrashtet e tij, që rridhnin nga të gjitha trojet shqiptare, ishte largpamës dhe vizionar i rrallë. Më kujtohet mirë kur ishim në udhëtim, për në takim me policinë lokale për të siguruar lejen për këtë manifestim publik, kur më tha: “Jemi tuj ndez një zjarr të vogël tasht. Ky aktivitet është porsi zjarr që ndez një ndër festa në bjeshtët e Shqipërisë, ku një mik del e tre hyjnë. Mos harro, Gjekë, se edhe ky aktivitet i yni, tashti i vogël, por do të vijë koha kur nuk do të na i nxanë shpirtja miqtë, të thirrur e të pa thirrur. Si zot shtëpie, ne kemi përgjegjësi të madhe dhe nuk do ta kemi të kollajtë. Por asgja nuk do të ndalojë nga arritja e qëllimit tonë. T'u japim vëllazëvë dhe motrave tona

Festivali i vitit 2008 u hap të shtunën më 30 gusht, dhe vazhdoi deri të hënën më 1 shtator në orët e fundit të natës. Në të vërtetë, celebrimi kryesor që përgatiti rrugë dhe siguroi parësinë dhe mirëmbajtjen e festivalit, ishte mesha solemne e të dielës ku bashkëmehuan don Ndue Gjergji dhe don Jeton Thaqi.



Pjesëmarrësit e akademisë kushtuar Nënë Terezë - Michigan

shqiptare të çdo besimi apo krabine dhe të çdo bindje politike që të kalojnë dy-tri ditë se bashku tue përjetue jetën dhe kulturën shqiptare. Mos u tut! Jemi nën mbrojtjen e Zojës Pajtores, dhe nën mbrojtjen e saj gjithmonë do të jemi fitues!” Sa i vërtetë ishte dhe mbetet vizioni i tij.

Festivali i vitit 2008 ishte ndër më të suksesshmit që nga fillimi deri më sot. Nën udhëheqjen e famullarit tonë të dashur Dom Ndue Gjergji, pasardhës i denjë i dom Prenk Ndrevashaj, i përkratur nga këshilli i kishës dhe nga dom Jeton Thaqi, i cili u bë dorë e djathtë dhe fuqi morale gjatë tërë manifestimit, si edhe nën udhëheqjen e zellshme të kryetarit të festivalit Gjon Viktor Pashkut, nga Stublla martire. Kështu, bashkësia jonë denjësisht e përsëriti traditën tashtë shumëvjeçare të bashkësisë dhe famullisë sonë Zoja Pajtores.

Kisha ishte e mbushur plot e përplot me besimtarë. Në fytyrat dhe në zemrat e tyre ndihet kënaqësia dhe momenti festiv. Shqiptarët, si zakonisht, janë gjithmonë të qeshur për nga natyra dhe të dashur me njëri tjetrin, por parapritja që gjendemi para një festimi të madh, e bënte atmosferën edhe më të lumtur dhe më të këndshme. Ku është më e mirë përçatja se sa pranë altarit duke i dëgjuar porositet e barinjve tanë, të cilët na porositnin me fjalën e Krishtit: “Duajeni Zotin me gjithë zemër dhe të afërmin si vetveten”.

Për ta bërë më të begatshme këtë ngjarje, mbas mbarimit të meshës u mbajt edhe një akademë e shkurtër, por shumë domethënëse, në përkujtim të jetës dhe veprës të bijës më të shtrenjtë të gjakut shqiptar, pra të lumës Nënë Terezë. Dom Ndue Gjergji shkurtimisht përshkroi jetën

dhe veprën e nënës Terezë, duke theksuar mundin dhe dëshirën e saj të madhe për ta mbrojtur jetën. Duke folur mbi abortin, tragjedinë më të madhe të Amerikës së ditëve tona, ai përsëriti fjalët e Nënë Terezë duke nënvizuar: “është vobekësi e madhe që të vendoset që një foshnje të mbytet, kështu që ti të kesh mundësi të jetosh si të duash”.

Kishte ardhur momenti që të bëhej hapja zyrtare e këtij manifestimi kaq madhështor. Bekimi dhe përshëndetjet e katër meshtrave tanë don Ndue Gjergji, Don Anton Kçires, Don Nosh Gjolaj dhe don Jeton Thaqi, e filluan zyrtarisht hapjen e festivalit, të cilët, pas lutjes, ua drejtuan besimtarëve nga një porosi të vogël duke u uruar atyre një jetë kohë sa më të mirë festive.

Festivali vazhdoi me argëtimin e grupit muzikor të Aleksandër Gjellajt, i lindur në Trabonin legjendar të Hotit, dhe Viktor Gjeshajt nga Koja kreshnike. Aq shumë u rrit atmosfera, sa që dikur nuk dukej më që gjendeshim në Amerikë, por diku në Tiranë, Prishtinë, Tuz apo Ulqin. Ushantonte kënga dhe hidhej vallja, këndohej lavdia dhe krenaria e kombit legjendar shqiptar. Mu në zemër të Michigan-it, si të ishte krijuar një Shqipëri e vogël. Po, së bashku me kishën e shën Palit, ku gjendet famullitar don Anton Kçira dhe bashkësitë tjera fetare që i përkasin kombit shqiptar, këtu në Michigan, mund të themi lirisht se e kemi krijuar një zemër shqiptare, që do të mbijetojë sa edhe vetë Amerika.

Për organizatorët ishte ditë e punës së dyfishtë, sepse duhej që të përgatitemi përsëri për vazhdimin e festivalit. Pastrimi anë e mbanë pronës se kishës, për-

gatitja e ushqimeve tradicionale shqiptare, pijet e freskëta, artikujt e ndryshëm kulturorë me libra dhe simbole të tjera kombëtare, lojërat e fëmijëve, mirëmbajtja e parkingut, sigurimi i brendshëm dhe i jashtëm, ishin në qendër të vëmendjes së meshtarit tonë dhe organizatorëve. Çdo gjë vazhdoi ashtu sikur ishte parashikuar, ndoshta edhe më mirë. Edhe moti ishte në favor tonin. Pjesëmarrja ishte aq e madhe, sa që pa dëshiruar ta teprojmë, numri ka arritur deri në 1500 veta. Sa mirë dhe sa kënaqësi që mund të takohemi dhe mund të jemi ata çka jemi. Jemi dhe do të mbetemi shqiptarë vëllazërit e motrat e nënës Terezë. Të tillë na njeh bota e civilizuar dhe të tillë do të mbetemi. Kemi jetuar dhe do të jetojmë në paqe dhe dashuri me njëri-tjetrin. Këtu tregohet natyrisht e vërtetë e shqiptarit: mikpritës dhe paqedashës.

Mbrëmja argëtuese e fundit të këtij festivali, u realizua nga grupi muzikor Shtjefën, Gjon dhe Lena Lulgjuraj. Këta këngëtarë burimorë nga Selishtja, Gruda legjendare, ringjallën tingujt dhe meloditë e këndshme të malësorit shqiptar. Pjesëmarrja e këngëtares së njohur shqiptare Hanë Nikëprellaj, me bashkëshortin e saj Kolë Nikëprellaj, i gëzoi të gjithë të pranishmit. Zëri melodioz dhe tingëlloes i Hanës shpërthente deri në qiell duke i kënduar shpirtit dhe natyrës heroike të kombit shqiptar. Për të nderuar dhe respektuar ligjin lokal, muzika u ndalua në orën 22:00. Me një falënderim të shkurtër dhe me urime të përzemërta për arritjet dhe sukseset të drejtuarra nga don Ndue Gjergji, përfundoi “Freedom Festival” 2008. Mirupafshim vitin e ardhshëm 2009! (Dr. Gjekë Gjellaj)

Pushoi së rrahuri zemra e një humanisti

Wilhelm Egger, ipeshkëv në Bolzano-Bressanone, kaloi në amshim. Ne ndoshta nuk e njohim shumë, por ai ishte një ipeshkëv, studiues, arkeolog dhe teolog i kishës së shenjtë. I lindur në vitin 1940, i përgatitur mirë t'i shërbejë kishës me zell dhe shenjtëri, studioi në Institutin Biblik Papnor. Mandej studioi arkeologjinë në Jeruzalem dhe më vonë ligjëroi në shkencat biblike në Bressanone dhe Innsbruck. Publikoi në gjuhën gjermane dhe italiane artikuj të panumërtë biblikë dhe teologjikë. Për ne është i njohur libri i përkthyer në gjuhën shqipe me titull “Misteri i fesë”, Ky libër shpjegon misterin e meshës së shenjtë.

Ky shërbëtor i Krishtit dhe i Kishës, u vu në shërbim të nevojtarëve. Kështu dora e tij bamirëse u zgjat në mbarë botën, sidomos në Afrikën e varfër

dhe në Azi. Ky njeri i shenjtë i Kishës arriti edhe në Kosovë. Ai menjëherë pas vitit 1999 dërgoi bashkëpunëtorët e vet në Kosovë që ta ndihmojë Kishën dhe Kosovën në rindërtim pas shkatërrimit të saj. Tërë ndihmën e vet e orientoi në ndërtimin e shtëpive të djegur. Ndërtoi edhe shkolla dhe ambulanca. Miqësia e tij me ne u rrit gjithnjë e më tepër. Ai ndërtoi dy Kisha në Kosovë: kishën në Poterq me një qendër të mirë pastorale si dhe kishën në Jagodë, po ashtu me qendër pastorale. Me ëndje vizitonte Kosovën. Herën e fundit ai vizitoi Kosovën në pranverë të këtij viti, nga 25 deri më 29 mars. Edhe ne, për ta nderuar dhe respektuar këtë të madh, të gjithë meshtarët dhe motrat e nderit patëm një takim shpirtëror dhe vëllazëror në Letnicë. Me këtë rast ai shprehi përvojën e

vet jetësore shpirtërore dhe ipeshkvore mbi misterin e fesë. Disi sikur ta dinte se po takohet për herë të fundit me Kishën tonë dhe me ne. Pas Letnicës ai vizitoi edhe Poterqin dhe Jagodën. Në Jagodë kremtoi meshën me një numër të madh besimtarësh. Shprehi me këtë rast gëzimin dhe kënaqësinë e tij që ka ndërtuar një vend lutjeje. Ai tha: “Një vend lutjeje është më i vlefshëm se çdo pasuri tjetër. Prandaj jam i lumtur kur ju shoh ju se këtu në lutje dhe meshën shenjte takoheni dhe bisedoni me Atin qiellor. Po kthehem në Italinë time, i lumtur që kam ndihmuar në ndërtimin e kësaj kishë.”

Humbem një mik të mirë dhe të madh në këtë botë, por tani kemi një mik edhe më të madh në qiell.

Pusho në paqe, vëllai ynë Wilhelm!
(Don Albert Krista)



Katekeza – Detyrë e Mbarë Kishës Katolike

■ SHKRUAN:
Dr. Don Lush GJERGJI

Pas Koncilit të Dytë të Vatikanit /KDV – 1962-1965/, në të cilin ishte kërkuar mënyra sa më e mirë dhe e përshatshme kohës dhe hapësirave të shpalljes së Ungjillit, shëlbimit të mbarë njerëzimit, kanë lulëzuar në venci dy fushëveprime: liturgia apo kremtimet e sakramenteve në gjuhët amtare, si dhe katekeza apo edukimi në fe, që tek ne tradicionalisht është quajtur besimi. Të gjitha dokumentet koncilare kanë pasur më tepër domethënie dhe përmbajtje pastorale se sa doktrinale, si dhe ishte mbështetur në dialogun e hapur dhe të sinqertë me botën e sotme të bazuar në të vërtetën dhe në dashurinë.

Vetëdijen e Kishës mbi dërgimin e saj në botën bashkëkohore, e ka shprehur KDV në kushtetutën dogmatike LUMEN GENITIUM /LG/, ndërsa marrëdhëniet e saj me botën si sakrament i shëlbimit në kushtetutën baritore GAUDIUM ET SPES /GS/.

Vështirësia kryesore e atëherëshme, por edhe e sotme, është kjo: ndarja e jetës nga feja dhe e fesë nga jeta, e cila shprehet nëpërmjet shekullarizmit, materializmit, ateizmit praktik, indiferentizmit, mentalitetit trupor-epshor apo hedonizmit, sidomos relativizmit, për të cilin ka folur shpeshherë po ashtu edhe papa Benedikti XVI. Ky dualizëm Zotit – njeriut, feja – jeta, trupi – shpirti, kjo botë dhe jetë dhe amshimi, bën që jeta dhe feja të jenë dy rrugime apo binarë paralele, por të ndara dhe të pavarura, që pakherë takohen apo përplotësohen, ndërsa në të shumtën e rasteve nuk kanë gati asgjë të përbashkët.

Me këto dukuri feja anësohet nga jeta, privatizohet, tjetërsohet, formalizohet, në sistemet komuniste-ateiste edhe ndalohet me dekrete, ndërsa në botën e ashtuquajtur “demokratike” thjesht përjashtohet nga përditshmëria. Sot njerëzimi kremen fitoren dhe ngadhënjimin e pavarësisë dhe lirisë edhe prej Zotit, fesë, traditës, moralit, duke e bërë njeriun pothuaj absolut, për të zhvlerësuar dhe relativizuar gati çdo gjë.

Për sa i përket katekezës, rëndësi të madhe ka botëkuptimi i Zotit dhe i njeriut, me pasojë vendimtare edukativo-katekistike. Botëkuptimi biblik dhe i krishterë i njeriut dhe njerëzimit kërkon që Zotin mos ta paraqesim vetëm si shpëtim të shpirtit, zgjidhje dhe përgjigje të jetës pas vdekjes, çështje kryekëput shpirtërore, por para së gjithash njerëzore dhe tejet konkrete, jetësore. Hyji konkret –Ati ynë i mirë kujdeset, ndërhy, ndërmjetëson, na shëlbbon në Jezu Krishtin konkret, me lindje, veprime, sidomos me mundime, vdekje dhe ngjallje të tij, dhe kështu ia mundëson nje-

sepsë Zoti është PERSON, dhe ai krijon persona, njerëz, të pajisur me liri, mendje, vullnet, mbi të gjitha, me shpirt të pavdekshëm. Zoti dhe njeriu në krishterim kurrrë nuk janë, e as që mund të jenë, antagonistë, armiq, kundërshtarë, por protagonistë, partnerë, bashkëpunëtorë dhe bashkëjetues, që teologu Y. Congari e shpreh kështu: Hyji në krishterim dhe në Jezu Krishtin është funksional, që domethënë në shërbim të njeriut dhe të mbarë njerëzimit.

1. Botëkuptimi i ri katekistik
Katekeza, edukimi në fe, mësimi i fesë apo besimi në këtë kënd-

het tërësisht në Jezu Krishtin. Kjo domethënë qartas se Zoti kujdeset për tërësinë e njeriut dhe të njerëzimit, si dhe njeriu nuk komunikohet me Zotin vetëm në disa raste të veçanta, në uratë, në kishë, në kremtimet e sakramenteve, por gjithnjë dhe në vazhdimësi dhe gjithkund, sepse janë tashmë të pandashëm. Mishërimi i Hyjit vazhdon historikisht nëpërmjet Kishës, dhe kjo gjë i jep njeriut mundësi të reja në dy këndvështrime apo drejtime: Zoti dhe njeriu dhe njeriu dhe bashkësia e krishterë.

Katekeza ka për qëllim integrimin e fesë në jetë, që domethë-

Katekizimi, pra, është edukimi i vazhdueshëm i fesë dhe në fe për jetë, për këtë jetë dhe botë, dhe vetëm në bazë të saj dhe pas saj edhe për pavdekësi dhe për amshim. Nëse humbet kjo harmoni mes njerëzores dhe hyjnore, kësaj jete dhe bote dhe amshimit, atëherë rrezikojmë që njerëzit të edukohen vetëm për Zotin, për qiell, ndërsa ata ende jetojnë në këtë botë, dhe kjo do të ishte disi “mashtrim”, apo ta themi edhe më qartë, nuk do të ishte edukim as për këtë jetë dhe botë as për amshim.

Feja është jetë me Zotin dhe me të afërmin, dhe jeta është fe



rëzimit risinë absolute të ndërrimit, përmirësimit këtu dhe tani, të shëlbimit dhe amshimit, i cili ngushtë ndërlihet me jetën njerëzore. Nga këtu buron humanizmi dhe personalizmi i krishterë,

vështrim, nuk është më vetëm bartja ose trashëgimia e mësimi të fesë, të vërtetave hyjnore, por edhe njerëzore, lidhja apo Besëlidhja e Zotit me njeriun, i cili na zbulohet dhe na dhuro-

në ndërlihdjen e Zotit në jetën e njeriut dhe anasjelltas, gërshtimin e jetës në Zotin, apo njeriun në Hyjin, sepse Zoti dhe njeriu kanë tashmë nevojë dhe dashuri për njëri-tjetrin.

– integrim jete në dy dimensione, sepse njeriu duhet gjithnjë të ndërlihdet së pari me vetveten, pastaj me të tjerët dhe me Zotin, Krijuesin dhe Shëlbuesin e vet, në këtë trekëndësh jetësor, në



harmonii dhe në bashkëpunim.

2. Katekeza sipas KDV

Sipas Koncilit të Dytë të Vatikanit katekizimi është detyrë primare e mbarë Kishës dhe duhet të përfshijë të gjitha moshat e besimtarëve, e jo si më parë vetëm fëmijët dhe vetëm në mënyrë intelektuale, si mësim feje, shpesh edhe formale, si detyrim për marrjen e sakramenteve. Kështu mungonte tërësisht përgatitja e prindërve për pagëzim, për rrefim dhe kungim të parë fare pak apo aspak, diçka më tepër për kungim të parë. Pastaj disi tolerohet një lloj ndërprerjeje apo zbrazëtie deri te krezmimi apo përforcimi, ose shpeshherë edhe ky sakrament merrjet me rrefimin dhe kungimin e parë. Përgatitja për sakramentin e ku-

Metoda e katekizimit sipas KDV është ajo e takimit, afrimit dhe bashkimit me Zotin nëpërmjet të afërmit dhe e të afërmit nëpërmjet Zotit, me besnikëri të të vërtetave të fesë dhe me metodologji didaktike përshtatur moshave, gjuhës, traditës, kulturës, aftësive intelektuale dhe morale, me mjetet didaktiko-aplikative të komunikimit bashkëkohor. Kisha zhvillon dialog të vazhdueshëm me botën e sotme, por gjithnjë e udhëhequr nga e vërteta e zbuluar dhe dashuria e dhuruar, Zoti, zbulimi i tij shkallor në historinë e shëlbimit, pa të cilin dialogu do të ishte monolog apo vetëm dialog ndërnjerëzor. Katekistët duhet ta kenë një përgatitje të mirë biblike, liturgjike, pastorale, por edhe duhet të rrijn sa më mirë botën e sotme, si

Këtë e pohon edhe dekreti mbi shërbimin baritor ipeshkvor CHRISTUS DOMINUS duke thënë: "Duke kryer detyrën e tyre të mësimi, ata duhet t'ua kumtojnë njerëzve Ungjillin e Krishtit... dhe kjo është një ndër detyrat kryesore të shërbimit ipeshkvor" /CD 12/.

Pas ipeshkvit janë meshtarët bartësit kryesorë të edukimit në fe, si me fjalë, mësim dhe katekizim, aq më tepër edhe me jetë dhe me dëshmi të krishterë. "Famulltarët /meshtarët/ po ashtu kanë për detyrë me mësim katekistik t'i udhëheqin besimtarët kah plotësia e njohjes së misterit të shëlbimit sipas nevojave të moshës së besimtarëve..." /CD 30/.

E njëjta detyrë u takon edhe xhakonëve, bashkëpunëtorëve të ngushtë të ipeshkvit dhe të meshtarëve, si dhe atyre që me predikime dhe me dashuri e bartin porosinë e krishterë tek populli i Zotit /Krh. LG 33/.

Katekizimi, po ashtu, është detyrë edhe e shekullarëve. "Laikët janë posaçërisht të ftuar që ta bëjnë Kishën të pranishme dhe aktive në ato vende dhe rrethana ndër të cilat vetëm nëpër ta mund të jenë kripa e botës... Prandaj le të përpiqen laikët me zell që të kenë njohurinë më të thellë mbi të vërtetën e zbuluar dhe të kërkojnë prej Zotit dhanti urtie" /LG 35/.

Nga kjo që është paraqitur në mënyrë bërthamore dhe panoramike kuptohet se Kisha Katolike në Koncilin e Dytë të Vatikanit, si dhe pas tij, thekson me bindje të thellë dhe me përcaktim të vendosur, mbi të gjitha me përkushtim dhe me dashuri detyrën e madhe të katekizimit, edukimit në fe për të gjithë të krishterët, veçmas për fëmijë dhe rini, për familjet e krishtera, pa të cilën nuk ka as riungjillëzim, zbulim, jetësim dhe dëshmi në jetën e krishterë.

“Katekeza ka për qëllim integrimin e fesë në jetë, që domethënë ndërlihdjen e Zotit në jetën e njeriut dhe anasjelltas, gërshetimin e jetës në Zotin, apo njeriun në Hyjin, sepse Zoti dhe njeriu kanë tashmë nevojë dhe dashuri për njëri-tjetrin.”

dhe metodat moderne katekistike dhe pastorale. Mu për këtë katekeza e mirëfilltë duhet të zhvillohet së pari në familje, si "kishë shtëpiake", pastaj në Kishë, në bashkësinë e krishterë, si vendi më i mirë dhe më i rëndësishëm për edukim në fe, sepse aty jo vetëm që mësohet feja, por para së gjithash dëshmohet dhe jetësohet.

KDV kërkon që vepruesi kryesor i katekizimit të jetë ipeshkvi, pastaj meshtarët, rregulltarët dhe rregulltarët, xhakonat, shekullarët, pra, me një fjalë, të gjithë të krishterët.

Kisha ripohon, në një Notë, nevojën që Ungjilli t'u kumtohet të gjithë njerëzve.

Këtyre ditëve u paraqit në Sallën e Shtypit të Vatikanit një 'Notë doktrinale' e Kongregatës për Doktrinën e Fesë, 'Mbi disa aspekte të ungjillëzimit'. Dokumenti, i miratuar nga Benedikti XVI, që ripohon nevojën e kumtimit të Ungjillit, duke shmangur rreziqet e relativizimit e të indiferentizimit fetar, u shpjegua nga kardinali prefekt i dikasterit, Uilljam Jozef Levada, së bashku me sekretarin, kryepeshkvin Angiolo Amato. Të pranishëm edhe kardinali Ivan Dias, prefekt i Kongregatës për ungjillëzimin e popujve dhe kardinali Frensis Arinze, prefekt i Kongregatës për kultin hyjnor dhe disiplinën e sakramenteve.

"Kumtimi dhe dëshimi i Ungjillit janë shërbimi i parë që të krishterët mund t'i bëjnë çdo njeriu dhe mbarë gjinisë njerëzore, të thirrur siç janë për t'u komunikuar të gjithëve dashurinë e Hyjit, që u dëftua plotësisht në Shëlbuesin e vetëm të botës, Jezu Krishtin". Nota citon këto fjalë të Benediktit XVI, për të ripohuar, duke respektuar plotësisht lirinë fetare, të drejtën e çdo njeriu për të njohur të vërtetën që shpëton dhe detyrën për ta shpallur këtë të vërtetë, e cila i takon çdo besimtar. Dokumenti flet për një konfuzion në rritje, që i shtyn shumë njerëz të mos i binden urdhërimit misionar të Zotit, duke e shikuar si të ishte atentat kundër lirisë së tjetrit, ose sjellje intolerante. Disa mendojnë se njafton të jepet ndonjë dëshmi shoqërore ose të ndihmohen njerëzit të jenë më shumë njerëz - e besimtarët, t'i besojnë më shumë fesë së tyre. Në sa në Notë ripohohet se Kisha është e nevojshme për shëlbimin e vërtetë, që nuk i kundërvihet faktit se Hyji dëshiron që të gjithë njerëzit të shëlbohen. Edhe

psë jo të krishterët mund të shëlbohen me hirin që Hyji e jep përmes udhëve të cilat i njeh ai vetë, Kisha nuk mund të mos e ketë parasysh faktin se atyre u mungon e mira më e madhe e kësaj bote: mundësia për të njohur fytyrën e vërtetë të Ungjillit, duke shmangur rreziqet e relativizimit e të indiferentizimit fetar, u shpjegua nga kardinali prefekt i dikasterit, Uilljam Jozef Levada, së bashku me sekretarin, kryepeshkvin Angiolo Amato. Të pranishëm edhe kardinali Ivan Dias, prefekt i Kongregatës për ungjillëzimin e popujve dhe kardinali Frensis Arinze, prefekt i Kongregatës për kultin hyjnor dhe disiplinën e sakramenteve.

Sot - vijon Nota - pluralizmi i ligjshëm i qëndrimeve ia ka lënë vendin një pluralizmi të padiferencuar, të bazuar mbi supozimin se të gjitha qëndrimet kanë të njëjtën vlerë. Përveç tjerash, respekti për lirinë fetare dhe promovimin e saj nuk duhet të na bëjnë në asnjë mënyrë indiferentë ndaj së vërtetës e së mirës. Nga ana tjetër - nënvizohet se liria fetare është një e drejtë që, për fat të keq, në disa vende të botës nuk njihet akoma ligjërisht, ndërsa në vende të tjera, nuk respektohet faktikisht.

Në frontin ekumenik, Nota nxit bashkëpunimin me konfesionet tjera të krishtera, duke i respektuar traditat e tyre, por edhe duke përjashtuar çdo lloj forme të 'konfuzionizmit'. Është fjala për të zhvilluar një dialog që respekton dashurinë dhe vërtetësinë; sjellje kjo që nuk e përjashton askënd nga përgjegjësia për t'ua kumtuar plotësisht fenë katolike të krishterëve të tjerë, pa u akuzuar për prozelitizim. Kisha - pohon Dokumenti - nuk synon kurrfarë pushteti: dëshiron thjeshtë që të gjithë njerëzit ta njohin plotësisht të vërtetën e të kenë mjetet e shëlbimit, për të hyrë në lirinë e në lumminë e bijve të Hyjit". (Radio Vatikan)



KDV katekizimin e bëri veprimtari dhe detyrë thelbësore për mbarë Kishën me këto qëllimi kryesore: edukimi në fe, që me fjalë tjera domethënë thellimi në njohjen, pranimin, zbatimin dhe dëshminë e fesë për të mundësuar veprën e shëlbimit, pjesëmarrjen e vetëdijshme dhe aktive në jetën e Kishës, në liturgji, në pastorale, në formimin e apostullimit /Krh. CD 14, 30; AG 30/.

Risia e parë e madhe e KDV është përfshirja e mbarë Kishës dhe e të gjitha moshave të besimtarëve në katekizim, sepse edukimi në fe është një proces jetësor i edukimit të vazhdueshëm në fe.

Etërit e Kishës

Luani i Madh

(390–461)

■ SHKRUAN:
Don Marjan DEMAJ

Mund të mrekullohemi me kohërat e ndryshme, të cilat ishin provë dhe ftesë për njeriun për të realizuar qëllimet e mira të shpirtit të vet. Kjo ndodh me Luanin, i cili arriti që prej një xhakoni të bëhet papë.

Sipas disa të dhënave, Luani me prejardhje ishte etrusk, i lindur në Romë, në vitin 390. Jetoj në kohën kur Kisha kishte nevojë për të dhe si xhakon dha një kontribut shumë të madh. Çirili i Aleksandrisë e kishte porositur dhe lutur që ta kryente një obligim shumë të rëndësishëm për Kishën. Në pikëpyetje ishte e drejta patriarkale mbi Palestinën. Ky e kreu bukur këtë detyrë dhe u çmua shumë si njeri me dije të shkathtë.

Aso kohe papë ishte Celestini. Sigurisht që Celestini papë nuk ka menduar se provania hyjnore do të bëjë që në vitin 440 në krye të Kishës të jetë pikërisht Luani, i cili do ta zëvendësojë atë. Luani ishte reformator i madh dhe në këtë kuptim shpeshherë edhe predikonte nëpër kisha. Luftoi shumë kundër herezive që ishin shfaqur në kohën e tij. Fjala është për një dioqezë ku pelagianët pa kurrfarë veshitërisë hynë në bashkësi. Papa, kur mori vesh, tha se duhet të diskutohet rreth tyre dhe ftoi sinodin e veçantë. Ashtu bëri edhe me manikejtë, kur në vitin 439 arritën në Romë dhe vepronin fshehtas. Në fund, papa Luani vendosi të bisedohet rreth veprimtimit të tyre dhe u mor vendim që të ndizen të gjitha librat e tyre. Kurse më 19 qershor të vitit 445 Valentini perandor shpalli ediktin kundër tyre.

Ashtu veproni edhe kundër priscilianëve në Spanjë më 21 qershor të vitit 447. Për në është e nevojshme të thuhet se papa Inocenti I dhe papët e mëparshëm, dëshironin të shtrinin dhe vërtetonin të drejtën e vet në mbarë Ilirikun. Papa në fjalë shpalli Selanikun si metropolitin, duke dashur që në këtë mënyrë të zbutë ndikimin që kishte Patriarku i Konstantinopolit. Për këtë gjë, papa Luani ua shkroi një letër të gjithë ipeshkvijve dhe u shpjegoi se Pjetri apostull ishte i pari duke e udhëhequr Kishën në tërësi. Për këtë të gjitha pyetje diskutabile, duhet të zgjidhen në Romë e jo në Konstantinopol. Ky arriti t'i bindë për të qenë Roma qendër e katolicizmit, por pas vdekjes së tij prapë filluan mosmarrëveshjet.



Altari i Shën Luanit të Madh në Bazilikën e Shën Pjetrit

Nga Luani sot janë të ruajtura 96 fjalime, të mbajtura në raste të ndryshme liturgjike. Këto fjalime janë të shkurtra, por me përmbajtje të thellë doktrinare. Një prej pyetjeve doktrinare, është ajo kur i drejtohet patriarkut të Konstantinopolit, Flavianit, me rastin e krizës monofizite. Luani definon dy natyrat integrale dhe të plota të bashkuara në Krishtin, por jo të përziera. Kjo ishte edhe baza e Koncilit në Kalcedon në vitin 451.

Për Luanin, Kisha e bashkuar me kryet e vet, Krishtin, është *Comunio sanctorum* – bashkësi e shenjtëve, e cila rritet dhe ushqehet me sakramente që bëhen efektive me meshtarinë e vetë Krishtit. Prania e Krishtit është arsye e ekzistencës së ipeshkvit të Romës si i Pari i Kishës. Si vikar dhe zëvendës i Pjetrit, është në mënyrë të veçantë i bashkuar me Krishtin, papa është garant i integritetit të Kishës, si në planin e bashkimit sakramental, ashtu edhe në bashkësinë

e shenjtëve. Po, ai është gjithnjë në *concordia sacerdotum* (Fjalimi 14,11) në lidhje me *collegium caritatis* (Fjalimi 5, 2; 6, 1; 12, 2).

Luani ishte mësues i Kishës. Papa Benedikti XIV e shpall edhe zyrtarisht për mësues të Kishës. Luani e meritoi një titull të tillë, sepse me aktet zyrtare dhe me predikimet e fjalimet e ndryshme, e tregon një inteligjencë të jashtëzakonshme. Të gjitha së bashku ishin 143 sish.

Kur i kanosej rreziku Kishës dhe gjendej në veshitërisë, Luani dinte aq mirë ta forcojë dhe ta ripërtërijë atë. Konstantinopoja u bë trashëgimtare e Perandorisë Romake dhe kështu Lindja u forca dhe priste që Roma, përkatësisht Perëndimi, të bjerë dhe të humbë lavdinë e vet. Luani vërtet nuk kishte mundësi të ndalë rënien e Romës, por e shpëtoi Kishën, të cilën e lidhi me Selinë e shenjtë. Sipas shumë teologëve, Kisha Katolike nuk pati njeri më kompetent në Selinë e shenjtë se shën Luanin papë.

Ja një fragment nga një fjalim i shën Luanit Mbi lindjen e Zotit tonë Jezu Krishtit:

"Vëllezër të dashur, sot është lindja e Zotit tonë Jezu Krishtit. Të gëzobemi! Nuk ka vend pikëllimi kur lind jeta, e cila asgjëson frikën nga vdekja, dhe e cila nxit gëzimin deri në amshim... Arsyja për gëzim u takon të gjithë njerëzve, sepse të gjithë ata janë mëkatarë. Klith nga gëzimi o i drejtë, u plotësua premtimi! Gëzohu, o mëkatar, sepse t'u mundësua shpëtimi, falja! Gëzohu o pagan, sepse edhe ti je i ftuar në jetë! Biri i Zotit mori natyrën tonë njerëzore që të na pajtojë me Atin... Ashtu, pra, djalli, armiku i njeriut do të jetë i mundur. Zoti në natyrën njerëzore e ka kundërshtuar armikun e vjetër, ai pra do ta përmirësojë atë që djalli e shkatërroi..."

Këtu shihet se si Luani flet me zemër duke iu drejtuar njerëzve si bari, si prind, si vëlla, si ai i cili tregon dashurinë për të gjithë.

Jeta e shën Luanit na mëson se ajo është një thesar, i cili duhet gjithnjë të zbulohet dhe të shkëlqejë dhe kështu të arrijë kulminacionin e vet. Luani shkëlqeu si xhakon, për të vazhduar në shkallën më të lartën si zëvendës i shën Pjetrit në Selinë e shenjtë.

Marrëdhëniet cilësore e bëjnë të qëndrueshme jetën bashkëshortore

■ SHKRUAN:
P. Shtjefën Dodes SJ

Ekspertët familjarë çështjen e komunikimit ndërmjet burrit dhe gruas e vlerësojnë shpesh herë si katastrofike. Me këtë nënkuptojnë edhe situatën e çështjes me seksualitetin brenda martesës. Këtu shumë çifte bashkëshortore e përdorin mënyrën e papjekur duke i mbyllur sytë dhe duke shkelur dhe kaluar lehtë përmbi një çështje kaq të rëndësishme. Njohësit e problematikës bashkëshortore tërheqin vëmendjen, se nëse seksualiteti në realitetin martesor lihet anash, shkaktohen probleme të mëdha në të gjitha fushat e jetës martesore.

Psikoterapisti Brajsha lidhur me qëndrueshmërinë e marrëdhënieve cilësore martesore shkruan: "Për të qëndruar në një marrëdhënie të gjatë martesore, marrëdhëniet seksuale bashkëshortore lypset të jenë dyanshmërisht fituese, dyanshmërisht të kënaqshme, dyanshmërisht të marrura vesh dhe të dëshiruara. Nuk është aq e rëndësishme kuantiteti (sa), sa është kualiteti (cilësia). Ato lypset të jenë akt kreativ i të dy partnerëve bashkëshortorë. Për ato duhet të flitet qartësisht, drejtpërdrejt dhe hapur, të punohet së bashku në to, të përsosën vazhdimisht, bashkërisht të adoptohen dhe të plotësohen, jo vetëm në planin fiziologjik, por edhe në atë shpirtëror, psikologjik, emocional dhe, në kuptimin më të gjerë të fjalës, në atë njerëzor, human. Duhet të detabuizohen (që të mund të flitet për to pa turp) dhe t'u jepet 'e drejta qytetare' në dialogun bashkëshortor, nëse dëshirohet të mënjanohet ferri bashkëshortor."

Në pyetjen se cilat martesat janë më të qëndrueshme, më të lumtura, përgjigjet: "Këto janë gjithësi martesat fleksibile. Në to partnerët bashkëshortorë janë të gatshëm të përshtaten dhe t'i ndryshojnë sjelljet e tyre në raportin e shoqishoqshëm. Ata vazhdimisht e ndryshojnë marrëdhënien e tyre në mënyrë që të mos vihen në sprovë që ta ndërrojnë partnerin. Është taktikë e tyre, që, në mënyrë të përditshme, t'i pasurojnë raportet me përmbajtje, ide, propozime, plane, dëshira të reja dhe me realizimin, zbatimin e tyre. Ata eksperimentojnë në mënyrë që të arrijnë të krijimtari të reja bashkëshortore. Do të mund t'i quanin inovatorë bashkëshortorë. Krijojnë pasuri variacionesh, ndryshimesh dhe inovacionesh

brendamartesore dhe jo jashtëmartesore. Këtu kërkohet një dozë optimale e kreativitetit nga të dyja anët."

Shpesh herë çiftet martesore dëshirojnë të shohin një model konkret të një çifti, që shërben si ndriçim dhe joshje për t'u imituar. Çfarë bëjnë çiftet, martesat e shëndosha? "Ato janë martesat në të cilat kultivohet dhe thellohet njohja me e mirë e shoqishoqshme, që ia mundëson

tesa të durueshme. Zhvillimit të martesës cilësore i duhet kohë. Shpesh herë kjo kohë është jo e sinkronizuar. Njërit i duhet më shumë kurse tjetrit më pak kohë që më mirë të njihen dhe të përshtaten. Partnerët bashkëshortorë lypset të kenë duresë, njëri-tjetrit ta presin dhe jo që ta ndërsejnë njëri-tjetrit, ta përshpejtojnë njëri-tjetrit, t'i pranojnë shpejtësitë e ndryshme të zhvillimit dhe ndryshimet

ekzistojnë) veç sa nxit konflikte me të mëdha martesore."

Duhet pasur para sysh se nuk është fare lehtë ta kuptosh gjininë tjetër (burri gruan apo grua burrin). Në vërtetë, besojmë se tjetrit mund ta kuptojmë mirë, mirëpo nganjëherë fitohet përshpejtimja se gati burrat dhe gratë flasin gjuhë më të ndryshme. Shumë mosmarrëveshje lindin, sepse po e zëmë te burrat një fjali apo një shprehje mund të

jashtë, por nuk është edhe keq, nëse nuk e bën."

Askush nuk na mëson çfarë dallimesh ekzistojnë në komunikim në mes gruas dhe burrit. Ndhimmon shumë, nëse njëherë e përgjithmonë ia qartësojmë vetes, se grua dhe burri komunikojnë në mënyra të ndryshme. Është e dobishme të merremi me këto dallime gjinore në formulime apo zgjedhje fjalësh.

Mos e merrni thjeshtë të vetëkuptueshme, se ju jeni duke e marrë vesh partnerin tënd. Në raste të paqarta nganjëherë mund të bëni gabime të mëdha. Më mirë shtroni pyetje më shpesh. Ja disa pyetje që mund të ju ndihmojnë:

- "Çfarë po mendon saktë me këtë?" Nëse e bëjmë këtë pyetje, i hapemi asaj, çfarë tjetri dëshiron të thotë. Kjo nënkupton se po e vlerëson dhe respektoni mendimin e tjetrit, po i jepni hapësirë atij/ asaj, po e shprehni gatishmërinë për dyanshmëri.
- "A jam duke të kuptuar Ty mirë, kur... (interpretimi juaj)" Me këtë ju i tregoni tjetrit, çfarë keni kuptuar dhe i jepni atij apo asaj mundësinë, këtë qëndrim ta vendosë korrekt. Nga kjo mund të lindë një bisedë e frytshme, sepse bëhet diçka e qartë, ku ju ndoshta e keni marrë vesh gabim.
- "Çfarë ke pritur ti? Sipas mendimit tënd çfarë do të duhej të kishte bërë? Çfarë dëshiron?" Këtu nuk kemi të bëjmë se ju prej tash e tutje duhet t'i kryeni të gjitha punët, çfarë partneri juaj kërkon prej jush. Kjo pyetje shërben më shumë, tjetrit për ta kuptuar. Nëse e dini, çfarë pret tjetri prej jush, mund të vendosni, se a e dëshironi atë çfarë do të vijë më vonë apo jo. Nëse vendosni të kundërtën, të paktën e dini, se tjetrit nuk i pëlqen dhe ju keni mundësinë të ardhurit keq të partnerit ta merrni vesh në një mënyrë tjetër.

Nuk mjafton pra vetëm të dëgjosh, të jesh pasiv, sepse "pas një kuptim-pranimi të fituar të vetvetes dhe martesës tënde duhet vijuar veprimi aktiv i dyanshëm. Kuptim-pranimi i fituar duhet medoemos të shndërrohet në veprim. Partnerët bashkëshortorë lypset të bëhen të aftë për veprim. "Martesat që qëndrojnë janë pikërisht ato që mbahen me aktivitet të dyanshëm të të dy partnerëve bashkëshortorë. Këto janë martesat në të cilat veprohet, që kultivohen, që nuk i lëshohen fatit, jo as vetëm Zotit të dashur, por që për çdo ditë ripërtërihen edhe përbrenda edhe përjashta."



“ Në pyetjen se cilat martesat janë më të qëndrueshme, më të lumtura, përgjigjet: “Këto janë gjithësi martesat fleksibile. Në to partnerët bashkëshortorë janë të gatshëm të përshtaten dhe t'i ndryshojnë sjelljet e tyre në raportin e shoqishoqshëm. Ata vazhdimisht e ndryshojnë marrëdhënien e tyre në mënyrë që të mos vihen në sprovë që ta ndërrojnë partnerin. Është taktikë e tyre, që, në mënyrë të përditshme, t'i pasurojnë raportet me përmbajtje, ide, propozime, plane, dëshira të reja dhe me realizimin, zbatimin e tyre. ”

edhe njërit edhe tjetrit partner bashkëshortor që vazhdimisht të zbulojnë njëri për tjetrin dhe njëri në tjetrin diçka të re dhe interesante. Në këtë mënyrë bëhen njëri ndaj tjetrit gjithnjë e më të prirur dhe më simpatikë. Kjo krijon mundësinë e një identifikimi më të fortë të ndërsjellë dhe zbulon më shumë pika ndërlidhjeje. Ato janë gjithësi edhe mar-

ë partnerit bashkëshortor. Për arritjen e një kuptim-pranimi më të thellë të vetvetes dhe të partnerit duhet kohë. Kuptim-pranimi është momenti më i rëndësishmi i një ndryshimi personal dhe të përbashkët në martesë. Liria e brendshme forcohet, kurse frika e brendshme fillon të humbet. Shtyrja e konflikteve të ndërsjella (sjellja se goja ato nuk

ketë krejt një kuptim tjetër se te gratë. Ja një shembull. Një grua e lut burrin e saj: "A mundesh ta çosh koshin e plehrave të shtëpisë jashtë, të lutem". Me këtë ajo mendon: "Çoje të lutem menjëherë koshin jashtë, se po qelbet dhe jam duke pritur." Mirëpo ai e ka mund të përjetojë "a mundesh" më shumë: "Çoje të lutem kur të mundesh koshin

Shtegtimi i Papës Benediktit XVI në t ka pushtuar zemrën dhe mendjen e f

■ SHKRUAN:
Don Anton UKAJ



Papa Benedikti XVI gjatë kremtimit të meshës në Lurd

Vizita apo më mirë të thuhet shtegtimi i papës Benediktit XVI në tokën franceze, me rastin e 150-të vjetorit të dukjeve të Zojës së Bekuar në Lurdë, pothuajse nga të gjithë ata të cilët e përcollën me vëmendje këtë udhëtim, është konsideruar si shumë pozitiv dhe frytdhënës për popullin dhe Kishën në Francë e më gjerë.

Prijësit shtetërorë, masa e madhe e popullit, e cila kish-te udhëtuar nga të gjitha viset e Francës për t'i dalë në takim papës, duartrokitjet, brohoritjet, lutja, përsëpirtëria dhe përqendrimi i vëmendjes në çdo fjalë që dilte nga goja e papës, dëshmuuan miqpritjen dhe dashurinë e madhe që populli francez ruan për papën. E tëra kjo krijoi një klimë të mirë dhe kushte të përshtatshme që ja mundësoi papës të shpalos me qetësi dhe butësi porosinë e Jezu Krishtit.

Vizita e papës në Francë pati dy etapa: atë në Paris, ku takoi krerët shtetërorë, njerëzit e kulturës, komunitetin hebraik, meshtarët, rregulltarët, seminaristët dhe të rinjtë; ndërsa tjetra etapë pati si pikësynim qytetin marian të Lurdit, ku takoi të gjithë ipeshkvijtë francezë, të sëmuret dhe të gjithë ata shtegtarë që kishin shkuar për të gjetur paqe, shërim dhe ngushëllim pranë trupores së Zojës së Lurdit.

Parisi ri-zbulon identitetin e vet

Papa, para se të zbriste në tokën franceze, kishte pohuar se ka një respekt dhe dashuri të veçantë për kulturën, për artin, për teologjinë dhe për tërë popullin francez në përgjithësi, sepse gjatë historisë dymijëvjeçare, pikërisht kjo tokë me njerëzit e saj, i dha një kontribut të pazëvendësueshëm Kishës dhe kulturës evropiane në përgjithësi.

Në fjalimin tij të parë para autoriteteve shtetërore të Francës, papa shprehi nevojën e një reflektimi të ri mbi domethënien dhe rëndësinë e vërtetë të laicitetit.

Benedikti i XVI ka theksuar që mes shtetit francez dhe Kishës mosbesimi i së kaluarës është shndërruar dalëngadalë në një dialog të qetë dhe pozitiv, që konsolidohet gjithnjë e më shumë.

Çështja e laicitetit ishte njëra ndër temat më të priturat ndër të gjitha ato që papa ka shtjelluar gjatë qëndrimit të tij katër ditor në Francë, dhe pikërisht kjo temë në ditët e fundit ka nxitur debate të mëdha pozitive në tërë territorin francez.

Papa ka rinxjerrë në pah shprehjen 'laicitet pozitiv', të përdorur nga vetë presidenti Sarkozy gjatë vizitës së tij në Romë para disa muajve.



Prijta e Papa Benedikti XVI nga zyrtarët e qeverisë franceze

Okën franceze francezëve

"Në këtë moment historik në të cilin kulturat ndeshen mes vete gjithnjë e më shumë, jam thellësisht i bindur që reflektimi mbi domethënien dhe rëndësinë e laicitetit të jetë më së e nevojshme".

Për sa i përket qëllimit të këtij 'laiciteti' - shpjegon papa - është shumë e rëndësishme, në njërin anë, të insistohet mbi dallimin mes sferës politike dhe asaj religjioze, me qëllim që të mbrohet liria religjioze e qytetarëve ashtu edhe përgjegjësia e shtetit ndaj tyre. Në tjetrën anë - shton papa - është e nevojshme për të pasur një njohje më të qartë mbi funksionin e pazëvendësueshëm të religjionit për formimin e ndërgjegjës dhe të kontributit që feja mund të sjellë, së bashku me instancat e tjera, në krijimin e një pëlqimi etik për tërë shoqërinë.

Funksioni i tillë i religjionit është posaçërisht i nevojshëm në shoqërinë aktuale, e cila ofron shumë pakë aspirata shpirtërore dhe pakë siguri materiale.

Papa në fjalimet dhe takimet e tij nuk mungoi të veçojë edhe kujdesin e tij të veçantë për të rinjtë: "Disa nga të rinjtë kanë vështirësi të madhe të gjejnë një orientim të përshtatshëm për veten e tyre, e disa të tjerë ndoshta vuajnë nga humbja e kujdesit nga më të dashurit e tyre".

Papa theksoi nevojën e krij-

mit të një kuadri të ri edukues në mënyrë që të ndihmojnë dhe të lehtësojnë vuajtjet e të rinjve dhe kështu të ndihmojnë ata që me një qetësi shpirtërore dhe mendore të arrijnë moshën e pjekurisë. Kisha - shtoi papa - mund të dhurojë një ndihmë shumë të madhe dhe të çmueshme në këtë drejtim.

Tema të tjera shoqërore që papa vuri në pah, ishin edhe rritja e tmerrshme mes të varfërve dhe të pasurve si dhe mbrojtja e ambientit, për të cilat papa kërkoi një angazhim dhe kujdes të veçantë nga të gjithë.

Benedikti XVI përmbylli vizitën e tij në Paris duke uruar dhe dëshiruar që ky popull, sikur në të kaluarën ashtu edhe tani, të luajë një rol civilizues duke ruajtur dhe mbrojtur rrënjët e lashta kristiane.

Lurdi: vend i mrekullive të shumta

Papa, me të arritur në qytetin marian të Lurdit, ishte i shoqëruar nga shumë ipeshkvij, në mesin e të cilëve ishte edhe ipeshkvi ynë mons. Dodë Gjergji. Gjatë qëndrimit të tij në Lurdë nuk ishin të parapara vetëm takimet, fjalimet dhe ceremonitë liturgjike, por papa kishte vendosur të bëhej shtegtar në mesin e shumë shtegtarëve, kështu që ai kaloi në lutje dhe meditim nëpër të gjitha ato vende ku Bernadeta jetoi dhe përjetoj dukjet e njëpasnjëshme të Zojës së Bekuar Virgjëres Mari.

Në takimin që Benedikti XVI pati me të gjithë ipeshkvijtë e Kishës në Francë rëndësi të madhe në fjalimin e tij i kushtoi familjes dhe ftoi të gjithë ipeshkvijtë që të kenë një kujdes të veçantë ndaj problemeve dhe vështirësive të mëdha që po përjetojnë familja; gjithashtu papa vuri në pah vlerën e madhe të meshtarisë dhe ftoi ipeshkvijtë t'i duan dhe t'i ndihmojnë meshtarët si dhe të promovojnë më shumë se kurrë thirrjet e shenjta.

Pastaj, në predikimet e bëra në Lurdë, ku ishin të pranishëm me mijëra e mijëra shtegtarë, shumë prej tyre me vuajtje të ndryshme trupore dhe shpirtërore, papa u foli për rëndësinë e madhe të këtij qyteti duke e quajtur: "vend

Besimtarët në kremtimin eucaristik me Papën Benediktin XVI



drite e lutjeje, shprese e kthimi në rrugën e Hyjit, ngritur mbi shkëmbin e dashurisë së Zotit, që arriti kulmin e dëftimit në Kryqin e lavdishëm të Krishtit. Në shkollën e Marisë, nxënësjë e parë dhe e përkryer e të Kryqëzuarit - vijoi Benedikti XVI - shtegtarët mësojnë t'i shikojnë kryqet e jetës së tyre, pikërisht në dritën e Kryqit të lavdishëm të Krishtit. Zoti na deshi aq, sa të jepte vetveten për ne: ky është mesazhi i Kryqit 'mister i vdekjes e i lavdisë'. Kryqi na kujton se nuk ka dashuri të vërtetë, pa vuajtje, se nuk mund të dhurosh jetën, pa dhimbje. Shumëkush e mëson këtë në Lurdë, që është shkolla e dashurisë në shërbim të vëllezërve".

Porosia e fundit e papës Benediktin XVI, drejtuar të gjithë shtegtarëve, duket të ishte kjo: "Maria, duke u shfaqur para Shën Bernardetës, i çeli botës një hapësirë të privilegjuar, për të takuar dashurinë hyjnore, që shëron e shëlbbon. Në Lurdë Virgjëra e Shenjtë na fton të gjithëve ta shikojmë tokën si vend të shtegtit tonë drejt atdheut përfundimtar, që është Qielli".

Statistika e Kishës në Francë

Kisha në Francë është një prani e gjallë dhe shumë dinamike në emër të Ungjillit vepron në shumë famulli dhe seminare, shkolla dhe spitale.

Mbi njëqind francezë, shtatëdhjetepesë janë katolikë.

Afër 46 milionë katolikë francezë kanë më shumë se 16-të mijë famulli. Franca ka 186 ipeshkvij, ndërsa meshtarët janë 21-të mijë (16-të mijë dioqezan dhe 5-së mijë rregulltarë). Kisha franceze ka më shumë se 2 mijë xhaxhkonë të përhershëm (permanentë). Të shuguruarit jo meshtarë janë 3 mijë dhe rregulltarët më shumë se 39 mijë. Jeta e bashkësive famullitare është e animuar nga 62 mijë katekistë. Për sa i përket thirrjeve të shenjta, seminaristët në seminarin e madh janë 1299, ndërsa ata në seminarin e vogël janë 134.

Në fushën e edukimit Kisha ka një hapësirë mjaft të madhe, shkollat për fëmijë e fillores janë 7113, ato të mesme 2726 dhe universitetet 356. Studentët që marrin pjesë në këto shkolla janë më shumë se 2 milion: 833 mijë në shkollat fillore, 1 milion e 200 mijë në të mesmet dhe 56 mijë në lami e ndryshme akademike. Kisha në Francë ka të vetat 94 spitale, 103 ambulanca, 520 strehimore për pleq, 96 strehimore për fëmijë dhe 247 qendra për edukim shoqëror.

Papa Benedikti XVI me të sëmurët





Intervistë me akademik Mark Krasniqi (pjesa e dytë)

Kisha katolike ka pasur njerëz të mëdhenj nga radhët e klerit në të gjitha fushat

Kisha katolike ka luajtur rol të madh në përparimin kulturor kombëtar, ka kultivuar dhe kultivon artin, letërsinë dhe idenë e bashkimit kombëtar. – Kam luftuar me këmbëngulje për ta bindur faktorin ndërkombëtar në Amerikë, në Evropë dhe në Australi, se populli shqiptar nuk është terrorist, fanatik fetar, muxhabedin, shkatërrimtar, joshetformues etj., siç na paraqet propaganda antishqiptare serbe, sepse shqiptarët janë popull i lashtë autokton në Ballkan, është ky një popull fisnik, tolerant, mikpritës, besnik, zemërgjerë dhe i orientuar gjithmonë drejt kulturës, politikës dhe demokracisë euro-amerikane, që nga heroi ynë kombëtar Gjergj Kastrioti – Skënderbeu në shekullin 15 e deri te humanistja më e madhe në botë e shekullit 20 – nobelistja e parë shqiptare, Nëna Terezë. Pra, ky popull i vogël ka merita të mëdha historike, të cilat faktori ndërkombëtar duhet t'i ketë sot parasysht.

Shumëkush thotë se ju keni kaluar një jetë jashtë Kishës, ashtu është dukur, por a ka qenë ashtu vërtet?

Mark Krasniqi: Sa më kujtohet, mësimi fetar thotë se Perëndia është gjithkund, në çdo skutë e jo vetëm në kisha, xhamia, në teqe, në sinagoga etj. Çdo fe, para së gjithash, e ka besimin, teorinë, bindjen, ceremonialin dhe rregullat e veta. Feja monoteiste, përmas kishës, xhamisë, teqesë etj., predikon moral, dashuri e mirëkuptim mes njerëzve, mëshirë e mirëkuptim ndaj nevojtarëve etj.. Si e tillë, ajo është jo vetëm e mirë, por edhe e nevojshme, e dobishme. Teoria dhe urdhrat fetare sublimohen në një porosi, ose urdhër të vetëm – “Mos i bëj askujt asgjë, çka nuk dëshiron që të bëjë dikush ty”. Ky është urdhri themelor, njerëzor, por tjetri është gjithashtu me peshë të madhe, është një shkallë më lart – “Nëse ke mundësi, bëji gjithkujt çka dëshiron të bëjë dikush ty”. Jam përpjekur që brenda mundësive gjatë gjithë jetës t'i përmbahem këtij parimi human. Kurrë nuk kam planifikuar për t'i bërë me qëllim keq dikujt. Por është e vërtetë që padrejtësinë, të keqen që ma ka bërë dikush pa kurrfarë shkakut nga ana ime, unë shpeshherë ia kam kthyer, jo për hakmarrje, po për ta dënuar dhe demaskuar keqbërësinë dhe për t'u informuar opinionin për realitetin. Me fjalë të tjera, unë nuk i përmbahem mësimit biblik kishar që thotë “Nëse dikush të bie shputë në një faqe, ti ktheja edhe faqen tjetër”, ose “Nëse dikush të gjuan me gurë, ti gjuaje atë me bukë.” Unë në të dy rastet veproj krejtësisht në kundërshtim

me këtë mësim, – shuplakën ia kthej me grushte e gurin me hu gardhi, sepse keqbërësi, terroristi, ziliqari, karrieristi, psikopati, i poshtri, nuk ndalet e nuk përmirësohet ndryshe. Madje, ai trimërohet dhe vazhdon punën e vet kriminale, nëse ti nuk reagon në këtë mënyrë. Populli thotë: “Pyka nxirret me puke!”

Fenë, moralin, kishën e xhaminë, njeriu duhet t'i ketë në zemër e jo vetëm në gojë

Akademia e Shkencave e Kosovës ka botuar vjet librin tim “Toleranca në traditën shqiptare”, ku kam paraqitur shumë shembuj të tolerancës fetare e kombëtare edhe të klerit katolik e mysliman shqiptar. Më duket se kjo tregon edhe qëndrimin tim ndaj fesë dhe ndaj institucioneve fetare në përgjithësi dhe ky libër mbetet si dëshmi dhe argument i përhershëm në favor të Kishës katolike shqiptare dhe të Xhamisë myslimane gjithashtu shqiptare.

Shumë intelektualë shqiptarë shkojnë në kishë e në xhami jo nga motivet fetare, por personale, politike, tregtare etj., dhe këta farisenj bëhen më katolikë se papa. Unë nuk shkoj në kishë as në xhami, por kam më shumë respekt ndaj tyre se shumëkush që shkon atje, madje edhe kungohet dhe falet e përkulet deri në dysheme. Nuk jam ateist, por disa gjëra nga Bibla e Kurani i marr me rezervë. Të them të vërtetën, nuk e lodhi mendjen me teori teologjike, merrem me punë të tjera, por disa festa e

ceremoni fetare edhe unë i respekttoj si traditë e jo si dogma, siç i konsideron edhe shumica dërmuese e besimtarëve të thjeshtë. Madje, disa festa e veprime bashkëkohore fetare kanë shumë ngjashmëri me besimet parakristiane, gjë që është e kuptueshme ndikimi e huazimi i elementeve të ndryshme nga përvoja e teoria e së kaluarës. Edhe feja monoteiste i ka përvetësuar disa sosh, për t'i tërhequr më lehtë masat pagane politeiste të deridjeshme, në fenë e monoteiste. Madje, edhe papa është ankuar njëherë, para shumë shekujsh, në këtë drejtim, duke thënë: “Besimtarët edhe pas 300 vjetësh pasi kanë kaluar në fenë krishtere, para se të hyjnë në kishë, kthehen drejt diellit, bien në gjunjë dhe e adhurojnë atë si perëndi, në vend që ta adhurojnë Zotin i cili e ka krijuar diellin”.

Pra, unë kishën e kuptoj ndryshe nga shumëkush. Kishën, përkatësisht normat e fesë, moralin, unë e kam në zemër. Në kishë nuk shkoj për të më parë populli, por reklamë, siç bën një numër jo i vogël i “besimtarëve”, para së gjithash i politikanëve dhe i intelektualëve karrieristë. Madje, në kishë, në tempull në Jeruzalem, kanë shkruar edhe farisenjtë, edhe tregtarët kanë shitur mallin e tyre në tempull, por Krishti ata i ka ndjek përjashta me kërbach shpinës. Do të bënte mirë Krishti që ta përdorte atë kërbach edhe sot ndaj farisenjve tanë bashkëkohorë.

Unë jam shumë mirë me klerin katolik dhe mysliman, sidomos me ata priftërinj dhe hoxhallarë që ecin përtokë, me halle, derte e interes të kombit, të

cilët nuk janë me mend në qiell e vetëm me këmbë në tokë. Kisha katolike ka luajtur rol të madh në përparimin kulturor kombëtar, ka kultivuar dhe kultivon artin, letërsinë dhe idenë e bashkimit kombëtar. Ajo ka pasur njerëz të mëdhenj nga radhët e klerit në të gjitha këto fusha. Unë nuk merrem me probleme teologjike, por besoj në të gjitha ato teori pozitive që m'i kap mendja, që mund të kenë bazë reale dhe që janë të dobishme për komb. Unë nuk jam ateist, as fetar fanatik. Fenë e marr si traditë të mirë, siç e marrin shumica e besimtarëve, pa hyrë më thellë në domethënie e përmbajtjen e festave dhe ceremonive fetare. Por me ma sharë ndokush fenë e të parëve, të traditës sonë shekullore, unë nuk do ta gjuaja me bukë, as nuk do ta ktheja faqen tjetër që të më bjerë edhe njëherë....

Shumë klerikë shqiptarë kanë qenë dhe janë jo vetëm fetarë, por edhe kombëtarë

Ka pasur mjaft lidhje tuaja si publike, po ashtu edhe të tjera, me klerin. Cilat kanë qenë ato lidhje dhe si i keni përdorë në të mirën e çështjes së Kosovës?

Mark Krasniqi: Unë para së gjithash e çmoj çdo individ si njeri, pa marr parasysht përkatësinë fetare, kombëtare, arsimore, profesionale, regjionale etj. Nëse ndokush nuk i ka vetitë pozitive njerëzore, moralin, sjelljet, veprimet, të paktën në suaza normale, për mua ai është njeri i dështuar, ka lindur i gabuar. Madje, edhe

nëse e ke në gjini gjakut të afërm si vëlla, nga njeriu i poshtër duhet të largohesh. Edhe vëllanë e ke vëlla vetëm nëse sillet si njeri, nëse është i ndershëm, i mirë. Përndryshe, s'e ke asgjë, largoje dhe largohu nga ai, sepse përndryshe do të bëhesh si ai, do të komprometohesh edhe ti me veprimet e tij të poshtra. Unë gjithmonë kam pasur telashe vetëm me njerëz të poshtër, me karrieristë, me njerëz të korruptuar, bile edhe me psikopatë e spiunë të UDB-s serbe, por sidomos me armiq të popullit shqiptar.

Unë njeriu që takoj për herë të parë, e konsideroj si të ndershëm, meqenëse kjo duhet të jetë normale, e zakonshme. Por ky është gabim, të cilin unë e kam bërë shumë herë. Shoku im i ndjerë, Sadik Tafarshiku, kur i thosha kështu për ndonjë person, ai me të drejtë më kritikonte: “Mos thuaj ashtu, pa hëngërr një thes kripë me të. Njeriu tregohet kush është vetëm kur të hypë në pushtet, kur të ketë diçka në dorë.” Por për klerin shqiptar të dy besimeve, kam menduar dhe mendoj se ky mendim imi është i drejtë, sepse prifti e hoxha janë njerëz të bekuar, kanë punë me Zotin, predikojnë moral e dashuri mes njerëzve, prandaj duhet të jenë, para së gjithash, ata vetë të tillë. Thashë, unë i çmoj klerikët, por sidomos ata që nuk janë vetëm fetarë, por edhe atdhetarë. Të tillë ka pasur shumë, ka edhe sot.

Kam qenë shumë mirë me ipeshkvin tonë të nderuar, imzot Nikë Prelëm dhe me imzot Mark Sopin. Jam mirë me shumë klerikë katolikë dhe myslimanë, sidomos me mikun tim Dr. Re-

Në kërkim të klerikëve të periudhës së Humanizmit

Ipeshkvi i Ulqinit, Martin Segoni, biograf i parë i Gjergj Kastriotit-Skënderbeut

Kur është fjala për përcaktimin e përkatësisë etnike të tij, çdo herë duhet mbajtur në mend edhe faktin se, Martin Segoni pjesën më të madhe të teksteve të tia ia kishte kushtuar historisë arbërore, dhe shkroi biografinë e parë kushtuar Gjergj Kastriotit-Skënderbeut. Ajo që tërheq më tepër vëmendjen këtu është se, origjina arbërore e Martin Segonit nuk është mohuar as nga historianët medievalistë të Akademisë së Shkencave të Beogradit.

■ SHKRUAN:
Prof. dr. Jahja DRANÇOLLI

Kur mbahet në mend fakti, se sot vepronjë më shumë studiues se sa në të gjitha kohërat e shkuara përgjithësisht, dhe mund të udhëtohet shumë më shpejt për të fituar pasqyrë më të qartë për përmbajtjet e thesareve arkivore e bibliotekare, prapëseprapë, zbulimi i burimeve të reja në ditë të sotme është gjë e rrallë. Një zbulim me rëndësi, që hedh dritë edhe për jetën dhe bëmat e Gjergj Kastriotit-Skënderbeut, për të cilin është folur më se një herë, paraqet vepra monumentale e bizantologut italian *Agostino Pertusi*. Ky studiues në Ambrozian të Milanos i zbuloi dorëshkrimet e *Martin Segonit*, një autor i shek. XV, i cili mbante titullin e ipeshkvit të Ulqinit, dhe kishte origjinë nga Novobërda (Artana) e Kosovës. Njoftimet e para për Martin Segonin ndërlihen me rekonstruimin e teksteve të tij, tradita e të cilave është tejet e komplikuar, e që për ekspertët medievalistë do të ishte fushë interesante studimi edhe sot e gjithë ditën.

Sikur theksonte edhe vetë zbuluesi i dorëshkrimeve A. Pertusi, humanisti ynë Martin Segoni që i humbur dhe i harruar, por jo edhe shkrimtar i panjohur. E citonin në veprat e tyre historianët më të mëdhenj humanistë, si, M. A. Sabeliko, M. Beçikemi, P. Jovius, M. Orbin, etj. Vepra jo komplete e Segonit, pjesërisht është e ruajtur në latinishten origjinale, diçka i përkthyer në italishtë, i ruajtur vetëm nga historiani italian S.

Razzi në Kotorr më 1589. Disa vepra të tij na kanë mbetur të njohura vetëm sipas titujve. Nga dorëshkrimet e ruajtura dihet fare pak për jetën e Martin Segonit. Tërthorazi nga disa dokumente raguzane dhe venedikase, mësohet se Segoni ishte nga Novobërda dhe ishte ipeshkëvi i Ulqinit. Mirëpo, në ballina të teksteve origjinale latine për të thuhet: *natione Catharensis* (kombësia kotorrare) *ex Novomontio aliter Novabardo* (Novobërda, vendlindja e tij). Në parathënien e S. Razzi-t, për Segonin, ndërkaq shkruante vetëm *gentilhuomo di Cataro* (bujar i Kotorrit). Është interesante të theksojmë këtu, se lidhjet e Skënderbeut me Novobërdën mund të ndiqen sipas dokumenteve të shumta. Mirëpo, një njoftim provon, se papa Kaliksti III, në vitin 1457, argjipeshkëvit të Tivarit për t'u bërë shok i Skënderbeut në kryqëzatë (i cili në këtë kohë planifikonte të kalonte në Zetë), në pranverë të vitit 1457, i ofronte kishën katedrale të Shën Nikollës në Novobërdë. Këtëj, Novobërda edhe pse në atë kohë ishte nën juridiksionin e ipeshkvisë së Kotorrit, shpallet si dioqezë e argjipeshkvisë së Tivarit - "*in ecclesia sancti Nicolai de Novomonte Antibarensis diocesis*".

Ajo që tërheq më tepër vëmendjen këtu, është se njoftimet nga dorëshkrimet zbulojnë vetëm fillimin dhe fundin e rrugëtimit të jetës së Segonit. Fillimi ndërlihet me Novobërdën, ku lindi në shtëpinë e t'et, Gjon Segonit, dhe fundi me Ulqinin, këtu, gjatë viteve 1482-1485 (para muajit tetor), në të vërtetë edhe pse për një kohë të shkurtër, rezidoi në

ipeshkëvinë e Ulqinit. Duke bërë hulumtime arkivore në arkiva të Padovës për shqiptarët në Universitetin e Padovës, ne kemi pasur rast që të ndeshim në njoftime që shpijnë në veprimtarinë e Segonit gjatë viteve 1474-1475 në Padovë. Në universitetin e kësaj qendre të madhe të kohës, kishte mbaruar studimet dhe në shkurt të vitit 1475 kishte mbrojtur doktoratën nga e drejta kanonike. Që në atë kohë mbante lidhje me

vendlindjen, Novobërdën. Këtu, gjatë këtyre viteve, e ndeshim, në cilësi të kanonikut të kishës *Shën Mëri* apo *kishës sase* (*Santa Maria in Nouamonte*). Më pak të njohura i kemi lidhjet e Martin Segonit me Kotorrin. Një familje nga segonët, e ndeshim në Kotorr në gjysmën e parë të shek. e XVI. Ka të ngjarë se këtu kishin ardhur pas pushtimit të Novobërdës nga osmanët më 1455. Aq më tepër, kjo dëshmi provohet

nga kërkimet tona në arkiva të Kotorrit, ku nuk kemi ndeshur në asnjë njoftim për ekzistimin e familjes Segoni në Kotorr para shek. XVI. Mbiemri karakteristik, si dhe besimi katolik i Martin Segonit, janë prova të sigurta për origjinën arbërore dhe lidhjet e tij me arbërit e Novobërdës gjatë shek. XIV-XV. Kur është fjala për përcaktimin e përkatësisë etnike të tij, çdo herë duhet mbajtur në mend edhe faktin

Statuja e Skenderbeut në Tiranë





“ Nga gjithë ajo që u
tha më sipër, del se
Martin Segoni paskësh shkruar
“Tregimin” për Skënderbeun
pothuaj një çerek shekulli para
veprës monumentale kushtuar
Fatosit tonë nga Marin Barleci,
çështje e cila nga studiuesit nuk
është kontestuar deri në ditët e
sotme. ”

se, Martin Segoni pjesën më të madhe të teksteve të tia ia kishte kushtuar historisë arbërore, dhe shkroi biografinë e parë kushtuar Gjergj Kastriotit-Skënderbeut. Ajo që tërheq më tepër vëmendjen këtu është se, origjina arbërore e Martin Segonit nuk është mohuar as nga historianët medivalist të Akademisë së Shkencave të Beogradit.

Në origjinalin latinisht janë ruajtur këto shkrime të Segonit: *Traktati mbi mbrojtjen e Otrantit dhe rregullimi ushtarak i Turkut dhe origjina e tij* (këtu Segoni bën fjalë edhe për rrugët e Ballkanit, si, rruga që shpie për në Kosovë, të cilën humanisti e quan Dardani; rruga Egnatia, që nga Durrësi dhe Apollonia shpie për në Lindje; përshkruan, gjithashtu edhe trevat e Arbërisë Veriore dhe Jugore); më pastaj shkrimet historiko-geografike: *mbi rrugët nga të cilat dëbët sulmuar turqit* (nga viti 1522 u ribotua disa herë, por në emër të austriakut Feliks Petançi); *mbi tokat dhe regionet nëpër të cilat Turqit mund të sulmojnë dhe mbi trevat e Dalmacisë prej të cilave barbarët ndërmarrin sulme në vende gjermane*. Që të dy këto tekste janë ruajtur në fondin e Razzi-t, të përkthyer italisht. Po në këtë gjuhë është ruajtur edhe biografia e shkurtër kushtuar Fatosit tonë me titull: *Narrazioni di Giorgio Castriotto, da i Turchi nella lingua loro chiamato Scander beg, cioe Alessandro Magno* (Tregim mbi Gjergj Kastriotin, nga turqit, në gjuhën e tyre, i quajtur Skander Beg, domethënë Aleksandër i Madh). Përveç këtij “Tregimi” të shkurtër kushtuar Fatosit tonë, Martin Segoni ka lënë edhe shkrime të tjera, në

të cilat ndeshim fragmente mbi Skënderbeun e familjen e tij, mbi Arbërinë e kohës së tij, si dhe skica jetëshkrim për historinë e heroit të kohës së tij.

Novobërda, vendlindja ku u krijua Segoni, në shek. XV zotëronte një ambient me kulturë të moçme qytetare. Nga ky qytet dolën autorë, si, Dhimitër Kantakuzeni, Kostadin Filozofi, Vladisav Gramatiku, të cilët dinin të lexonin në origjinal autorë grekë e latinë, “madje dinin të shkruanin në latinisht të bukur libërshkat e tyre”. Këtu jetoi dhe veprimi një kohë, shkrimtari dhe historiani i madh bizantin Jan Kantakuzeni. Segoni mori këtu dituri humanistike. Interesimin për historinë dhe gjeografinë e vendeve ballkanike, humanisti kosovar e barti me vete në Itali, ku padyshim do ta ngritë edhe nivelin e diturive të gjuhës latine dhe shkencave klasike, të cilat u shprehën fuqimisht në traktatet e tia të njohura.

Lexuesit të sotëm, padyshim, më tepër do t’i kishin interesuar shkrimet e Martin Segonit kushtuar Gjergj Kastriotit-Skënderbeut. Segoni kishte prije, që në një vend në shkrimet e tij, ndonjë çështje, së pari të trajtonte ca më shkurtër, dhe më pastaj, në një vend tjetër ta trajtonte ca më gjerësisht po atë çështje. Kështu, në shkrimin *mbi origjinën e turqve*, i qaset shkurtazi Skënderbeut, dhe më pastaj, Fatosit tonë ia kushton një tekst ca më të gjatë. Duke u nisur nga kjo logjikë, “Tregimi” kushtuar Skënderbeut është shkruar diku gjatë viteve 1481-1485, meqë deri në vitet 1481/82, Segoni i kishte shkruar të gjitha veprat ku për-

mendat më parë Skënderbeu. “Tregimi” i Segonit kushtuar Skënderbeut, i cili ruhet sot në Bibliotekën Kombëtare në Firence, kishte parë dritën fill pas rënies së Kruijës dhe Shkodrës (1478/79) dhe pas disfatës turke në Otranto (1481), pra diçka më shumë se dhjetë vjet pas vdekjes së heroit. Atëbotë, humanisti ynë rezidonte në ishëkvinë e Ulqinit, qytet ende i pashkelur nga turqit, dhe seli pranë teatrit të operacioneve” më të bujshme të Skënderbeut.

Nga gjithë ajo që u tha më sipër, del se Martin Segoni paskësh shkruar “Tregimin” për Skënderbeun pothuaj një çerek shekulli para veprës monumentale kushtuar Fatosit tonë nga Marin Barleci, çështje e cila nga studiuesit nuk është kontestuar deri në ditët e sotme. Mirëpo, duhet potencuar se teksti për të cilin po bëjmë fjalë, është shumë më i shkurtër se teksti i Barleci. Në këtë kontekst, e quaj me vend, të shtrohet pyetja se sa ka pasur njohuri Barleci për shkrimet e Segonit. Derisa janë të njohura lidhjet e Marin Beqikemit me Segonin, lidhjet e tilla nuk janë të njohura ndërmjet Segonit dhe Barleci. Humanisti shkodoran, pavarësisht se i ka njohur apo jo shkrimet e Segonit, nuk e përmend atë në asnjë vepër të tij. Por në kohën kur shkroi Barleci, jeta dhe bëmat e Skënderbeut, në mesin e arbërve por edhe të huajve ishin të njohura. Edhe pse nuk dihet aq sa që ndikuar Barleci nga “Tregimi” i Segonit, një çështje është e sigurt, se edhe Segoni edhe Barleci shkruan histori të vërtetë, histori që përjetsoi jo vetëm jetën e bëmat e

Gjergj Kastriotit-Skënderbeut, por nëpërmjet të tij u përjetësua edhe Arbëria.

Pjesë të zgjedhura nga dorëshkrimi i Martin Segonit me titull: *Narrazioni di Giorgio Castriotto, da i Turchi nella lingua loro chiamato Scander beg, cioe Alessandro Magno* (Tregim mbi Gjergj Kastriotin, nga turqit, në gjuhën e tyre, i quajtur Skander Beg, domethënë Aleksandër i Madh):

“Lindi Gjergj Kastrioti nga Gjoni, zot i Arbërisë [...]. I cili zot, Gjoni, duke mos mundur t’u qëndronte armëve turke, pati paqen nga Murati me disa kushte, njëra prej të cilave ishte që ai t’i jepte djemtë e tij peng, e në mes tyre Skënderbeun, i cili, i rritur në oborrin e turkut dhe i mësuar në kulturën turke, pati kaq përfitim sa, që nëntëmbëdhjetë vjeç (Barleci e jep 18 vjeç, ndërkaq Frëngu 19 vjeç - J. D.), që bërë sanxhak [...]. Dhe duke pasur një pamje mbretërore, u simpatizua shumë nga Murati [...]. Kështu Murati thoshte plotë gojën, publikisht, se ai ishte krahu i tij, syri i tij i djathtë dhe mbrojtësi i pashoq i shtetit të tij”. “I erdhi, ndërkaq të atit, Gjoni, për të vdekur, ushtritë turke pushtuan atë mbretëri, gjë për të cilën Skënderbeu u qa (por) që ngushtuar nga Murati, duke i dhënë shpresë se së shpejti do ta vendosë në fron personin e tij. Po, duke mos bërë gjë më tej, bile duke bërë (Murati) që të vëllezërit e tij të vdisnin me helm, ai (Skënderbeu), me shkathësi dhe me shkresë të falsifikuar vajt në Arbëri. U bë zot i disa fortesave kryesore. Dhe pastaj, pasi u mblodhën në kuvend popujt e provincës në fjalë e të gjithë Maqedonisë (trojet

këndej e andej Drinit), që njohur prej tyre princ i ligjshëm e thirrur mbret [...]”. Me sa duket Segoni që i pari prej historianëve që pohan se, Skënderbeu mbante titullin mbret. Deri vonë, për titullin mbret të Skënderbeut i referoheshin veprës së *Lavarënit* të botuar në vitin 1576.

“Më vonë, që thirrur nga Piu II në Itali, për të bërë të përgjithshëm në ndërmarrjen që shenjteria e tij mendonte kundër turqve. Po duke ndërhyrë vdeka e Pontefecit në fjalë, tjetërkuhsh nuk vazhdoi”.

“Ndërkaq, duke u kthyer në arbëri, dhe ndërsa në Lezhë, mbi lumin Drin, po konsultohet me proveditorin venedikas rreth çështjeve të luftës, e rroku një ethe ngjitesë (dhe) kaloi në jetën më të mirë, në vitin e Zotit tonë një mijë e katërqind e gjashtëdhjetë e shtatë, në moshën gjashtëdhjetë e tre [...]”. Segoni jep të saktë datën: sipas kalendarit venedikas i bie viti 1468; kështu bëri më vonë edhe Frëngu; ndërkaq, Barleci dhe Muzaka, jepin vitin 1466, d.m.th. 1467.

“Që qarë vdeka e këtij kalorësi të madh jo vetëm nga tërë Greqia, po njëkohësisht nga tërë princërit e Evropës, si dhe nga turqit vetë, të cilët, pas vdekjes së tij, duke u bërë zotër të gjithë Arbërisë dhe duke gjetur në kishën e Shënkollit, katedrale e qytetit të Lezhës, trupin e tij, devotshmërisht e nderuan me respekt të madh. Dhe, sipas supersticionit të tyre, nxorën eshtrat fatlume nga varri, duke besuar secili se do të gjendej i sigurt në betejë, po të kishte lidhur me vete një pjesë, sado të vogël, të një kapiteni kaq të pathyeshëm”.

Nga Panteoni i Trashëgimisë

Etosi i Pleqnisë

Atë Shtjefën Gjeçovi: "Libri i njimbëdhjetë Kanuni i Pleqnisë" Nga KANUNI I LEKË DUKAGJINIT

■ SHKRUAN:
Prend BUZHALA

Në Antikën greke **logos-i** dhe **ethos-i**, dija dhe virtyti, ishin e njëjta gjë; ishin dy faqet e së njëjtës medale. Kurse **praxis-i** e kishte pjesë të veten, të pandarë, **theorisis-in**.

"Kanuni i Lekë Dukagjinit" (KLD), nga ky kënd, përbënte të drejtën zakonore dhe normat fillimisht të pashkruara e të transmetuara nga brezi në brez. Pra, përbënte etosin dhe logosin shqiptar. Kurse **praxis-i** dhe **theorisis-i** ngjizeshin e ndërtheshin në të memorizuarit e tyre në kujtesën e kombit. Që nga viti 1913, kur Atë Shtjefën Gjeçovi filloi ta mbledhë të drejtën zakonore shqiptare; që nga viti 1933, kur KLD u botua si vepër postume e fratit martir; që nga atëherë kjo vepër ka hyrë edhe në fushën e privilegjeve të Kulturës së Shkrimit.

Sado që KLD mban autorësinë e Gjeçovit, kjo vepër, si e tillë, merr pjesë në kulturën autentike shqiptare, në formësimin e identitetit kulturor e në atë të vlerave nacionale kulturorë, nga njëra anë, po edhe në "trashëgiminë e mendësisë juridike popullore shqiptare, tek është arritur në konfigurimin e së drejtës kanunore shqiptare" (Xhyher Cani), nga ana tjetër. Prandaj, KLD, së këndejmi, është i pashkëputshëm nga vlerat e traditës e të thesarit kulturor nacional. Të parët tanë, përmes memories kolektive ndër breza, i dhanë fytyrë, përmbajtje e trajtë qenies sonë edhe përmes Kanunit.

Semantika e numrit, Libri i Njëmbëdhjetë

Nga problematika e gjërë e dymbëdhjetë librave të KLD, kësaj radhe, veçum disa aspekte e refleksione të librit të njëmbëdhjetë, që mban titullin "Kanuni i Pleqnisë".

Përse dymbëdhjetë libra? Numri dymbëdhjetë, në semio-

logjinë e shkrimit gjeçovian, ka ngarkesë semantike etno-kosmogonike. Ky numër do të ndërthet edhe paradigmen e shkrimit historiko-letrar antik. Gjeçovi ishte gjurmues e gjakues i lashtësisë, i etnopsikologjisë dhe i dokeve shqiptare. Ai flet për dymbëdhjetë fise, për dymbëdhjetë pleq etj. Numrat hynorë kanë forcën e tyre magjike. Ndërsa numrin njëmbëdhjetë, të libri i njëmbëdhjetë, "Kanuni i Pleqnisë", do ta konsiderojmë numër emblemantik qiellor, (për numrat çift Xh. Cani thotë se janë tokësorë). Semilogjia e numrit çift **dymbëdhjetë** të çon të kërkimin i harmonisë, ndërsa njëmbëdhjetëshi do t'ishte "numër i krizës", numër i çasteve në kapërcyell

kohësh apo të gjetjes së alternativave. Kurse Gjeçovi zgjedh Alternativën e Harmonisë, ashtu sikundër këtë parim e gjakon secili Kanun, pra, secila Kush-tetutë europere-ndimore, për të krijuar bashkësi harmonike njerëzore. Ishte, ky, ai gjakimi e parimi i lashtë bibliik për Kopshtin e Edenit, pra për ndër-timin e Parajsës në Tokë përballë parashikimeve apokaliptike e katastrofike të fundit të njerëzimit apo të fundit të qytetërimit.

Nëse në librat tjerë kërkitimi i dokeve apo i të drejtës zakonore, si trajtë e lashtë e rregullimit të marrëdhënieve shoqërore, shikohet në raport me Kishën, Familjen, Martesën, Shpinë, Gjanë, Pronën, Punën, Të Dhanunat, Nderën, Damet, Mbrapshtitë, dhe së fundi, të Shlirimit e Përbashkimit, libri i parafundit, këto raporte i vë përballë urtisë, gjykimin dhe drejtësisë, pra përballë Pleqnisë. Prandaj, urtinë, mençurinë, vetitë e karakterit, drej-

tësinë dhe, përgjithësisht, **pleqninë**. Gjeçovi i kërkon të libri i njëmbëdhjetë.

Semilogjia e Aksiologjia e Plakut dhe e Pleqnisë

Në mendësinë juridike popullore shqiptare fjala **plak** shënon parësinë e katundit a të fisit, shënon burrin që thirret për gjykimin e një çështjeje apo grindjeje. Ndërsa fjala **pleqni** tregon gjykimin, peshimin apo zgjidhjen e një çështjeje me pleq të thirrur prej të interesuarve. Në traditën e lashtë e të pasur të vlerave kombëtare, po edhe universale, pleqnia ishte ngritur në **instytucion shqiptar**. Kjo mendësi, sa e veçantë, aq edhe

të KLD, po edhe në Kanunin e Skënderbeut,, në Kanunin e Labërisë, nëpër kanune të veçanta të bajrakëve të Dukagjinit, në besëlidhjet e ndryshme, siç janë Besa e Malsisë së Madhe, Besa e Lezhës, Besa e Krutës etj. Gjithashtu e hasim edhe në Kanunin e Maleve. "Kanuni ka pengun, pengun pleqninë e pleqnia drejtësinë, tue i dhanë gjithkujt çka i përket", theksohet nëpër korpuset tekstore të këtyre kanuneve. Ekzistonin pleqtë e ndarjes, që ishin burra me përvojë. Institucioni i Pleqnisë, si të gjykatat moderne e demokratike, përmbante procedurën e vet të veçantë, provat, mjetet e provës, (R.Halili), përmes betimit apo

Fjalës së nderit (Qe besa), Kapucarit, dëshmitarëve, porotës e poronikëve, argumentimit përmes të zanunit e kryesit në vepër, ndjekjes së gjurmëve të shtazës së vjedhur apo të shenjave tjera, **dorëzanëve**, marrjes së vendimit, të drejtës për ankesë te Dera e Gjon Markut, etj.

Fiset kishin njëfarë autonomie që i rregullonin marrëdhëniet e tyre në mënyrë të pavarur (Ragip Halili). Secili fis kishte nga katër kësi pleqnarë. Çështjet që kishin rëndësi të madhe, si ato midis të konflikteve midis fiseve, trajtoheshin nga një lloj i veçantë i pleqnisë, siç ishte Pleqnia e Madhe (paragrafi 1003, 1005 të "Kanunit të Pleqnisë"), në të cilën merrnin pjesë pleq me famë e flamurtarë (a bajraktarë) fishes "të regjun e të shkathët" në zgjidhjen e konflikteve. "Pleq thirren edhe burrat ma në za për urti" (paragrafi 994 i KLD). Pleqnia përbëhej nga disa pleq, apo anëtarë, që t'i

kujton anëtarët e një kolegji gjyqësor modern.

Si tek gjyqet moderne, edhe pleqnia kishte kompetencat e veta. Ja disa theksime: "Plaku i pengut nuk mund t'i lypë të falmet e t'premet e kanus, pa e nreq punen." Ndërkaq, sipas Kanunit të Pleqnisë, edhe vetë **pleqtë i nënshtrohen ligjit**, por i nënshtroreshin edhe vegjëlisë apo **vojgëlisë**, po edhe **djelmënisë**, ashtu siç veprohet në botën e qytetëruar, ku para ligjit janë të barabartë si kryetari i shtetit, ashtu edhe qytetari thjeshtë. Pleqnia ngrihet në autoritet të veçantë shoqëror e juridik, kurse pleqtë duhet të jenë të ndershëm, të paanshëm e të drejtë.

Figura e plakut, siç thekson Xhyher Cani, ishte ajo e burrit të urtë e të ditur në fushën e të drejtës zakonore. Kurse sipas tipologjisë së kësaj trashëgimie e mendësisë, ekzistonin Plaku i Fisit, Plaku i Katundit dhe Pleqtë e Flamurit. Këta të fundit përbënin Parinë e Vendit, ose "oxhakun", si formë e tillë e organizimit në shumë fshatra. Mendësia mitologjike, religjioze dhe ajo shoqërore e përshkon tejandëri personalitetin e fortë etik-moral të Plakut, ashtu sikundër do ta karakterizojë edhe Drejtësia, Urtia dhe Të regjunit në punë të gjyqeve.

Nga ana tjetër, nuk ishte rastësi, që Institucionin e Flamurit a të Bajrakut e drejtonin flamurtarët (kurse me islamizimin e popullsisë bajraktarët), tek e përfaqësonin pushtetin ushtarak, pushtetin gjyqësor dhe pushtetin vetëqeverisës. Nga ky këndvështrim, do të thoshim se kështu përfaqësohej e spikatej ndërgjegjja për shtetësinë, sado që gjatë shekujve që ndërjer mungesa e shtetit nacional shqiptar. Këtë mëvetësi nacionale përballë të huajve e pushtuesve, në mënyrë të veçantë e spikat Kanuni.

Flamurtari a Bajraktari gjithmonë flamurin e ruante në shtëpinë. Luftëtari që e merrte flamurin, i printe ushtrisë dhe fitonte titullin flamurtar ose bajraktar,

“ Nëse Institucioni i Pleqnisë ishte i njohur tek popujt antikë për të zgjidhur konflikte e mosmarrëveshje me anën e mjeteve paqësore e të ndërmjetësimit, vetë Gjeçovi dikund e përmend se kjo traditë e pleqnisë e ka burimin te shtetet e para ilire, për të vazhduar në Mesjetë te principatat shqiptare. ”

universale, është rrezatim i urtësisë krijuese popullore, e mençurisë dhe i filozofisë së shpirtit nacional.

Nëse Institucioni i Pleqnisë ishte i njohur tek popujt antikë për të zgjidhur konflikte e mosmarrëveshje me anën e mjeteve paqësore e të ndërmjetësimit, vetë Gjeçovi dikund e përmend se kjo traditë e pleqnisë e ka burimin te shtetet e para ilire, për të vazhduar në Mesjetë te principatat shqiptare. Ekzistencën dhe praktikën e këtij institucioni e hasim që nga shekulli XV e këndeje, jo vetëm në disa variante

“ Në këtë mes, prin kapitulli për Kishën apo Hija e Kishës e figura e Priftit. Do të thotë, se pos fondit mitologjik (Cani), kemi edhe mendësinë e krishterë, si shenjë e identitetit evropian të shqiptarëve, sepse kisha e krishterimi përbëjnë një shenjë të përbashkët të identitetit evropian të kombeve; se themel e parim kryesor i etosit evropian e atij nacional është besimi në Hyjin, sepse prej këtij besimi del edhe përsosmëria e moralit dhe e së drejtës. ”

prijës, udhëheqës ose plak (Kanuni i Skënderbeut, paragrafi 1754).

Së këndejmi, struktura dhe problematika e pleqnisë dhe e pleqve, ishte mjaft e ndërlikuar dhe e ndërliqshme, tek përbën-te, si e tillë, një sistem interesant vlerash të kulturës e të trashëgimisë shqiptare, dhe, pse jo, edhe të qytetërimit evropian. Të “Kanuni i Pleqnisë” Gjeçovi këtë strukturë të ndërliqshme pleqsh e të pleqnisë, e paraqet me këto shenjinë, sikundër janë: Plaku i pengut, Pleqtë e Kanusë, krenët e Kanunit, Pleqtë e Krenët e Falmurit, Pleq e Vogjli, Strapleqtë apo Stërpleqtë që mbajnë anën e Vogjlisë, Plaku i Katundit, Pleqnija a Gjygi, Gjygi i Pleqvet, Porota e Ponorikët, Kapucari, Pritëtarët e Kapucarit, Burrat e Malevet, Pleqtë e Fiseve, Kasneca fishes e katundesh, Dera e Gjon Markut, Gjobtarët, Vogjia, Leçija, Lajmëtarit etj. Secili prej tyre dhe secila kapitull e pleqnisë, përmban një semiologji të tërë shkrimore e kuptimore, por ato përbëjnë edhe një sistem të tërë vlerash etiko-nacionale të papekshme.

Në këtë mes, prin kapitulli për Kishën apo Hija e Kishës e figura e Priftit. Do të thotë, se pos fondit mitologjik (Cani), kemi edhe mendësinë e krishterë, si shenjë e identitetit evropian të shqiptarëve, sepse kisha e krishterimi përbëjnë një shenjë të përbashkët të identitetit evropian të kombeve; se themel e parim kryesor i etosit evropian e atij nacional është besimi në Hyjin, sepse prej këtij besimi del edhe përsosmëria e moralit dhe e së drejtës. Por Gjeçovi i ndan Të drejtën Hyjnore prej Të Drejtës Njerëzore: “Kisha gjendet e vendosme nën sundim të të Parit të Fes e jo nën ligjë t’ Kanunit”. Mendojmë se këtu, te ky princip i kulturës e i civilizimit evropian dhe te kjo alternative e ndarjes së shtetit nga kisha, e ka burimin edhe “kundërshtimi” i “Ligjës së Lekës” apo i “malsorëve” ndaj


“predikimeve” të klerikëve që binin ndesh “Ligjës...”.

E pra, sipas parimit të shtetit demokratik modern, feja dhe pushteti qeverisës, gjyqësor e ushtarak janë të ndarë. Këtu nuk ka të bëjë asgjë me privilegjet që Kanuni po ia njihka Kishës. Kurse Kanuni, sikundër theksohet, është produkt i marrëdhënieve të hershme shoqërore! Mbese, KLD ishte “nga ma të vjetrat ligje të Evropës” (revista “Shkodra”, 1965, fq 335). Do të thoshim: është produkt i kulturës, i civilizimit e identitetit evropian të ilirëve-arbërorëve-shqiptarëve. Le të jenë sot dëshmi përdallimi shtetit teokratike aziatike, që ndryshojnë nga kultura e civilizimi evropian dhe në fjalorin e të cilave ndryshe lakohen fjalët kulturë, civilizim dhe identitet. Po të ishte ndryshe, Atë Shtjefën Gjeçovi, si klerik, nuk do t’i hynte një punë që bie ndesh me petkun e tij fetar, apo jo!

Te e fundit, çfarëdo ndryshimesh që të kenë ndodhur, ky etos nacional apo ky etos kanunor, do të ketë mbijetuar. Aty e kanë gjetur vendstrehimin e tyre, mbese gjithnjë prej frikës përballë të panjohurës e përballë ndryshimeve apo asimilimeve të huajve që e rrezikojnë apo e zvetënojnë këtë identitet! Nga ky këndvështrim, Kanuni ishte një e fortë për të ndërtuar e ruajtur kulturën autentike nacionale, me shenjinë të forta humaniste e demokratike, përballë depërtimit asimilues të islamizimit, që po e zvetënohte dhe zhdukte autoktoninë shpirtërore shqiptare. Prandaj, të yshur nga pushtuesit e mercenarët e pushteteve, zvetënimë të shumta i kanë ndodhur edhe Kanunit, prej lakmisë për të vënë pushtet mbi njerëzit dhe mbi pronën.

Libri i Njimbthetë Kanuni i Pleqnisë, në strukturën e

vet ngërthen një problematikë të gjerë dhe komplekse. Nis me Njën Njiqindekatërdheteëparë “Tagri e detyrat e Pleqvet”, që zëbërthet në 26 paragrafë, vazhdon me Nye njiqindekatërdheteëdytë “Pengjet” (në 17 paragrafë), “Shtim Pleqsh” (10 paragrafë), “Porota” (në 36 paragrafë), “Kapucari” (12 paragrafë), “Pritëtarët e Kapucarit” (në 12 paragrafë), “Burrat e Malevet të Shqypnis në Kuvend” (6 paragrafë), “Vende kuvendesh” (14 paragrafë), “Dera e Gjon Markut” (20 paragrafë), “Krenët efisevet” (16 paragrafë), “Pleqt e katundevet” (7 para-



grafë), “Strpleqtë” (3 paragrafë), “Gjobtarët” (5 paragrafë), “Zani Vogjlis ndër gjyge” (3 paragrafë), “Leçija” (15 paragrafë), “Zjarmi, të sodum e të grimunt” (6 paragrafë), “Lajmtari” (13 paragrafë) dhe deri te Nye i njiqindepësedhetendandët “Kasneci” (në 8 paragrafë). Këto “Nye”, secili veç e veç, përbëjnë interpretime e pikëshkime të veçanta të këtij shkrimi, të cilat nuk përfshihen këtu.

Njih vetveten / Tautotes / Identitas

Pra, në strukturën e gjerë të kësaj

problematikë që shtron libri i njëmbëdhjetë i KLD, Kanuni i Pleqnisë, plaku dhe pleqnia kanë statusin e tyre specifik juridik, por e kanë edhe etosin e tyre. Duke pasur parasysh faktin, se janë pak popuj që e trashëgojnë që nga lashtësia traditën kanunore e traditën shtetërore evropiane; atëherë edhe tradita iliro-arbërore-shqiptare hyn në universin e pluri-identitetit evropian të kulturës e të sistemit të vlerave. Sipas traditës sokratiane “Njih vetveten”, edhe vetë Aristoteli e përmend fjalën **tautotes** (të jesh vetvetja, ndërkohë që

latinët kishin për këtë gjë fjalën **identitas**. Së këndejmi, edhe tradita e veçantë e etosit të plakut e të pleqnisë tek ne, përbën vetveten tonë, pra, e paraqet atë jetën autentike shqiptare të vetëregulluar e të vetorganizuar. Piter Berger do të thoshte se strukturat shoqërore specifike, si dhe strukturat e tilla historike, i krijojnë **tipat e identitetit**, të cilët do të mund të përveçoheshin e të njiheshin në shumësinë e në përdallimet e këtyre strukturave.

Te “Kanuni i Pleqnisë”, po përgjithësisht te KLD jo pak studiues i pëkulen prirjes gjuhësore e sintezuese të Gjeçovit, tek ka arritur që t’i veçojë ato formula e një-sil ligjërimore-stilistike (si “Beja merr gjanë e vet”, “Beja lanë gjaqet”), të nocioneve shqiptare të së drejtës zakonore (ndore, dorëzanë, kapucar), të njësisve e formulësimeve ligjërimore që shprehin esencën etnike apo “palcën e etnisë” (si lisi i gjakut, lisi i tamblit), apo të semantizimit etnopsikologjik të fjalëve-nocione si mik, besë, gjak, burrë, be, gur, plak, zjarm etj. Apo si bën hire formula shqiptare e mikpritjes: “Buka e krypa e zemra, zjarmi e trangu e do firi për shtrojë do të gj-

ndet gadi për mik në çdo kohë të natës e të ditës” (KLD, paragrafi 609); apo i besës si virtyt i lartë njerëzor: “Me çue gjind për besë asht kanu, me dhanë asht detyrë e burmi” (KLD, paragrafi 855).

Do të thoshim, se KLD dhe Kanuni i Pleqnisë do të përbëjnë **identitetin e përjetuar** dhe **identitetin e projektuar**: të universin e pluri-identitetit evropian të kulturës e të sistemit të vlerave. Emil Benveniste dikund thotë se fjalët **kulturë** dhe **civilizim** (qytetërim), janë krijime e fjalëfomime brenda identitetit kulturor evropian: “E tërë historia e mendimit modern dhe ndryshimin e disa fjalëve qenësore, të cilat iu takojnë gjuhëve të Evropës Perëndimore”. Krijuesi e dijetai ynë, Sabri Hamiti, Kanunin e sheh njërin ndër tri monumentet e kulturës shpirtërore të shqiptarëve, duke theksuar se ai ndërton “kultin e përsosmërisë morale (besë, trimni, burmi)”. Nuk ishte për t’u habitur, prandaj, pse tradita e këshillave të pleqve, gjatë viteve ‘90, u ngrit në **këshilla të pajtimit**, në Lëvizjen e madhe të Pajtimit të Gjaqeve, duke paraqitur para vetes dhe para botës fytyrën e një populli të civilizuar, që di, në momente të caktuara historike e shoqërore, si t’i mënjanojë dukuritë ndëshkimore të dëshme për trupin e kombit. Gjakkmarja mbahej e ushqehje nga institucionet e huaja e nga ato të totalitarizmit e jo nga KLD, siç iu pëlqen të thonë ideologëve të “humanizmit socialist” në Kosovë apo gjetiu. Prandaj, pas shembjes së ngrëhënis totalitare, në Kosovë del në skenën e historisë edhe njëherë Alternativa e Harmonisë dhe e krijimit të shoqërisë harmonike shqiptare. Si te miti biblik i harmonisë. Kjo alternativë, gjithësi, e ka burimin te Kanuni. Te logos-i dhe ethos-i shqiptar.

Kompozimet e Ballatës me temë shpirtërore-begati e muzikës së shënjtë shqiptare

Perëndimorja në muzikën e Zeqirja Ballatës (II)

Me këto kompozime, ai e ka identifikuar veten si një krijues me qasje të re në krijimtarinë tonë muzikore, me gjuhë bashkëkohore, pra edhe në veprat për Nënë Terezë (ose siç e ka quajtur Klajd Kapinova në monografinë e vet "Engjell vuajtjeje dhe shprese"), këtë shenjtore shqiptare.

■ SHKRUAN:
Akil Mark KOCI / Londër

Kompozimi tjetër kushtuar Nënë Terezë është sipas kësaj poezie të Liri Loshit:

Nëna Terezë
Një copë bukë në dorë
Mori botën në sy
Kjo tokë e ka lindur
Si mua si ty

Bukën e kësaj toke
E ndanë në njëmijë pjesë
Siç ndan rrezet dielli
Mbi lulet plot vesë

Bota n'gojë të ujkut
Në gjumë ariu
Në skenë Nëna Terezë
Gonxhe Bojaxhiu

S'ma bën të njohur Tokën
Vetëm fjala Besë
Mbi botë tok me qiellin
Nxen Nëna Terezë

Ajo nuk është
Veç e këtij nënqielli
Është e të gjithëve
Siç është dhe dielli.

Është për soprano e piano, e kompozuar më 1990, në 80-vjetorin e Nënë Terezë dhe e interpretuar shumë herë nga këngëtare shqiptare e slovene (të shoqëruara nga autori), në koncerte e festivale në Kosovë, Kroaci, Shqipëri, Slloveni, si dhe i janë bërë vlerësime të shumta.

Parti i solistes është me kërkesa të larta teknike, intonative e intervalesh të ndryshme dhe karakterizohet nga përdorimi sidomos kërcimesh të kuartave (perfekte e të zmadhuara) si dhe të septimave (madhore e minore), pastaj të tingujve të mbajtur gjatë, pak a shumë të tipit "iso", me disa "corona", si dhe

të vlerave të ndryshme ritmike: grupnota vlerash 16-tëshe, 8-she, triola, sekstola, septola etj. Kjo vlenë edhe për partin e pianos, i cili përfshin edhe disa veçori të tjera që autori i ka përdorë këtu e disa dhjetëvjetsha më parë: "pizzicato"-t në tela të pianos, gruptingujt e tipit "cluster", "arpeggio"-t dhe akorde nga më të ndryshmet. Ndërsa, një tjetër tipar i përbashkët i

krejt veprës është se autori këtu, si edhe në vepra të mëparshme, jo rastësisht është çliruar plotësisht nga përdorimi i masës (i masave) metrike. Këtë e ka bërë me qëllim që vija tejet ekspresive melodike e sopranos të jetë sa më e lirshme dhe të shprehë në mënyrë bindëse përmbytjen e ndjeshme, të hollë (tempi i veprës: Sentito) poetike, pra edhe muzikore të kësaj vepre.

Gjithë kësaj i vijnë në ndihmë edhe shënjat agogjike, përkatësisht të artikullimit dhe larmia dinamike: "p", "mf", "f", "mp", "pp", "ppp" etj.

Laudate Mater Theresia mbi tekstin omonim latinisht (shih dhe në gjuhën shqipe!) të autorit është kompozuar për soprano, bri anglez, gerrëz («guiro»), kambana, tam-tam, triangël, akordeon (fizarmonikë) e piano në shtator

1997 me rastin e kalimit në përjetësi të Nënë Terezë:

Dies ater - et luctus
Veneris die - quinto Septembris
nonaginta septem
Pro immaculata, sacra, humana
Matre Theresia alias Gonxhe
Bojaxhiu - Albanica
Pro missionaria miserorum,
liberorum, senum,
aegrorum



Zeqirja Ballata

“ Të gjitha këto kompozime, për të cilat bëmë fjalë më sipër, paraqesin në hapësirën mbarëshqiptare pasuri të muzikës së shenjtë, si shprehje artistike që nxjerr në pah preokupimet e kompozitorit bazuar në tekstet e poetëve tanë dhe të tjera, ku Ballata gjeti frymëzim për të portretizuar dy figura historike, duke i poetizuar me imazhe të qarta të shpirtit lirik. ”

Gloria Matri benedictae
Pro vita eius
Aeterna oramus
Amen.

Pikëllim ditëzezë.
E premtë – pesë shtator –
nëntëdhjeteshtatë
Për t'papyrlyerën e shënjtë
gjithënjërzore
Nënë Terezë alias Gonxhe
Bojaxhiu Shqiptare
Misionare e të sëmurëve
plëq fëmijë bonjakë
T'vetëm pashpresë.

Lavdi!
T'bekuarës Nënë
Uratë gjithmonë
- oj jetë e jetëve
Amen.

Zgjedhja e këtillë e solistes vokale dhe e instrumentaria (umi)t ansamblor është bërë jo rastësisht. Sopranoja shpreh përmes përmbajtjes dorozore dhembjen për Nënë Terezë (rëshqitjet, elementet deklamative, lamentoriale edhe përmes përsëritjes së tingujve, kërcimeve të rënda, të jozakonshme, përzgjatjeve me “koronë”); briri anglez i bashkangjitet me ngjyrimet mallëngjyese (vibrimet për një çerek tingulli “sopra e sotto”, tremolot, tingujt e mbajtur, frullatot, kërcimet në intervale të zvoçëluara e të zmadhuara); gerrëza (popullore), që në disa vise shqiptare lajmëronte një ngjarje të hidhur; celesta, me tingullin i saj (që konsiderohej dikur) qiellos; kabanat me domethënien dhe kumtimin e tyre të posaçëm; tam-tami, me kumbimin e tmerrshëm ogurzi; fizarmonika me disa elemente teknike efektive (frullatot e posaçme, “frymëmarjet” përmes rëshqitjet instrumentit); pianoja, me përdorim tingujsh të «preparuar», me “pizzicato” në tela, me klas-terë (“clusters”) hijerëndë. Një-

herazi, autori në dy seksionet që e përthekojnë veprën, ka hequr dorë nga masat metrike (taktet) me qëllim shprehjen sa më të lirshme individuale, intime të solistes vokale, por edhe të secilit instrument veç e veç.

Vepra është shfaqur me sukses në Slloveni, për herë të parë në teorin e vitit 2000, për nder të lumturimit të Nënë Terezë n'interpretim të ansambllit “Contempora” – Slloveni (Jolanda Korat-soprano, Dushan Kërjak-bri anglez, Karmen Hlade-fizarmonikë, Zeqirja Ballata-piano, Martin Bajde-veglat me goditje). Që interpretuar edhe më pas, më 12 janar 2001, në Sallën kamerale të Operës e Baletit në Maribor. Vepra paraqet motivin e lartësisë humane si tërësi e mendimit filozofik, lidh atë transversale të nervit jo vetëm lirik por edhe dramatik. Pra, këtu hasim në një zhvillim evolutiv të brendshëm, falë poezisë, por edhe dhuntisë së Ballatës, duke na e sjellë dhe prezantuar e shpalosur madhërishtëm fytyrën e shenjtores sonë, Misionarës së të sëmurëve - plëq e fëmijë bonjakë e të pa shpresë. Me tingullin më se të përshatshëm, del në pah vitaliteti shpirtëror i kësaj figure të madhe e të shenjtë. Në sajë të poezisë që ndez ndjenjat, kompozitori, me anë të tingujve, në mënyrë të drejtpërdrejtë konkretizon shqetësimet e botës së sotme si protestë, kritikë apo edhe ligërim individual.

Ja ç'thotë autori për një veprë tjetër të kompozuar po atë vit (1997) me titull “*Dona nobis*” për kor katërzësh të të rinjve, flaut, «glockenspiels», triangël e piano në këtë tekst të tij (të vitit 1993) të poshhtënuar:

Dona...
Dona nobis...
Dona nobis pacem

...Nobis pacem
...Pacem

...Nobis pacem
Dona nobis pacem
Dona nobis...
Dona...

Dona nobis...
Dona nobis pacem
...Nobis pacem
...Pacem
Amen

Për nga tematika muzikore, ajo mbështetet mbi një melodi të hershme anonime, të cilën autori këtu e ka ndryshuar, përpunuar, mbarështruar në mënyrën e vet. Motivi bazë tematik muzikor është gjithnjë i pranishëm duke kaluar shpesh prej njërit zë në tjetrin, ndërkohë që zërat e tjerë mbajnë tinguj të gjatë ose kanë pushime të pjesshme. Kështu, vijat melodike të mbështetura fuqimisht në tekstin dhe përmbajtjen e tij, dalin gjithnjë në pah. Njëherësh e ka korpusi koral edhe mbështetjen e kohëpaskohshme të flautit, dy veglave të tjera perkusivë, por edhe të pianos paksa karakteristike (“pizzicato”-t, “glissando”-t në tela, klasterët). Vijat melodike të zërave koralë (përdoret edhe “parlando”-ja) anojnë nga një tonalitet i lirshëm, ndërsa pjesërisht glockenspieli dhe pianoja, por sidomos vija melodike e flautit, me laryshinë ritmike, praninë e disa “frullato”-ve, “glissando”-ve etj., ndërthun në vetvete me shumë elemente (motive) seriale me qëllim zgjerimin (pasurimin) e ngjyrave të partit koral.

Një deçenie më parë (1987) kompozitori Ballata e pat kryer një veprë tjetër tejet të rëndësishme vokalo-instrumentale për recitator, bas solo, kor e ansambël orkestral me titull *Pro Memoria 1462*, në të cilën gjejmë shprehje imazhe interesante. Vepra omonime është kompozuar me

rastin e 525-vjetorit të Formulës së pagëzimit të Pal Engjëllit, të cilin kompozitori Ballata, i frymëzuar nga Formula... (si fjali e parë shqipe zbuluar), e ka zgjeruar duke ia dhënë formën e një poezie, por edhe ngritur Pal Engjëllin në piedestalin më të lartë fetar-arsimor-kombëtar:

Un'...
Përgëzjonj...
P'r emënit Atit e t'Birit
Përgëzjonj p'r emënit Atit e t'Birit e t'Trimit
Un' përgëzjonj p'r emënit Atit e t'Birit e t'Trimit t'Arbënit
Përgëzjonj p'r emënit Atit e t'Birit e t'Trimit
P'r emënit Atit e t'Birit
Përgëzjonj Shqip
Un' Pal Engjëlli
1462.

Ky tekst poetik e ka parë dritën në gazetën “Rilindja” më 1987, kur edhe është interpretuar (dirigjent B. Jashari) kjo veprë vokale-instrumentale për herë të parë me të njëjtin titull për recitues (H. Shehu), bariton (A. Derguti), kor dhe ansambël orkestral (Kori e Orkestra e RTV-Prishtina). Pas ekzekutimit janë bërë vlerësime tejet pozitive, kurse autorit i është dhënë (për herë të dytë) Shpërblimi vjetor i ShKK – herë në parë i është dhënë më 1977 për veprën “Glissandi” për violinë e piano. Në veprë, jo rastësisht, është “cunguar” korpusi orkestral me synimin që elementi përmbajtësor të vokalet, domethënë me recitues deklamues (me vlera të caktuara ritmike), të basi solistik (vlera të ndryshme ritmike, kërcime lart e poshtë intervalsh të ndryshme, tingujt e mbajtur gjatë), tek i gjithë ansambli koral (linja recitative-deklamative, linja të ngjashme me modelin e vjetra, me “iso”-t tona të Jugut dhe me këngët arkaike, “rëshqitje” e “susurando” të ndryshme), të dalë në

pah dhe të mos “mbulohet” nga orkestra, e cila këtu është kryesisht në shërbim të elementit vokal të veprës. Prandaj i gjithë ansambli orkestral: flautet e klarinetat (me tremolot, trilerët, frullatot, grupnotat e përsëritura...), veglat perkusivë me praninë e tyre të rëndësishme, violonçelët e kontrabasët me një trajtim paksa të pazakonshëm (“pizzicato”-t e theksuara, grupnota që përsëriten, flazholetë natyralë e artificiale...), si dhe dy pianot (tingujt e «preparuar», klasterët, grupnotat që përsëriten, “glissando”-t në tela, goditjet me shuplakë në tela...). Të gjithë këta elementë janë të pranishëm me finesa teknike dhe të trajtuar si të thuash solistikisht. Gjithashtu, në veprë, krahas teknikës dhe mundësisë të përdorimit bashkëkohor, të solistëve, korit apo të ansambllit orkestral, janë të pranishme edhe aleatorika e mbikëqyrur, pra edhe çlirimi nga metrika e fiksuar.

Të gjitha këto kompozime, për të cilat bëmë fjalë më sipër, paraqesin në hapësirën mbarëshqiptare pasuri të muzikës së shenjtë, si shprehje artistike që nxjerr në pah preokupimet e kompozitorit bazuar në tekstet e poetëve tanë dhe të tjera, ku Ballata gjeti frymëzim për të portretizuar dy figura historike, duke i poetizuar me imazhe të qarta të shpirtit lirik.

Me këto kompozime, ai e ka identifikuar veten si një krijues me qasje të re në krijimtarinë tonë muzikore, me gjuhë bashkëkohore, pra edhe në veprat për Nënë Terezë (ose siç e ka quajtur Klajd Kapinova në monografinë e vet “Engjëll vuajtjeje dhe shprese”), këtë shenjtorë shqiptare.

Në mbyllje të këtij punimi, dëshiroj të theksoj se, krahas vlerave artistike dhe estetike, këto vepra të kompozitorit Zeqirja Ballata mbartin e kumtojnë edhe sublimimin filozofik.



TA NDIHMOJMË NDËRTIMIN E KATEDRALES

*Jam mik i Kishës Katolike
dhe dua ta ndihmoj
ndërtimin e Katedrales
"Nëna Terezë" në Prishtinë!*

Gjithë juve miq dhe bamirës
të dashur, ju mundësojmë ta
jepni kontributin përmes xhi-
rollogarive bankare.

Faleminderit!

Raiffeisen BANK
Kosovo J.S.C.
Prishtina, Kosovo
SWIFT code: RBKORS22

Adm. Ap. e Prizrenit
Numri i llogarisë:
EUR: 1501 090000 1990 20
USD: 1501 090000 3765 30
CHF: 1501 090000 3764 33

Valuta	Banka	Shteti	SWIFT/BIC
EUR	Raiffeisen Zentralbank Oesterreich AG	Vienna, Austria	RZBAATWVV
USD	American Express Bank, LTD	New York, US	AEIBUS33
CHF	UBS AG	Zurich, CH	UBSWCHZH80A

ABONONI "DITËN"

Tash mund të jeni abonues të revistës kulturore të Kishës Katolike në Kosovë "Drita". Për vetëm 12 euro në vit (ose 1 euro për secilin numër), ne do t'ju dërgojmë **me postë "Dritën"** (vetëm brenda territorit të Kosovës).

Plotësoni formularin e mëposhtëm, dhe na e dërgoni bashkë me vërtetimin e pagesës në adresën tonë: **Rr. Gjon Pali II 1, 20000 Prizren.**

Emri: _____

Mbiemri: _____

Adresa: _____

Qyteti: _____

Kodi postar: _____

Numri i telefonit: _____

E-mail: _____

Pagesa prej 12 eurosh mund të deponohet në Raiffeisen Bank Kosovo, në llogarinë 1502 0310 0086 0188. Ju lutemi, mos harroni ta futni fletëdeponimin në zarf bashkë me këtë formular. Ju faleminderit!

Për informata më të hollësishe, ju lutemi të na kontaktoni në numrin e telefonit: 029 241 933/14, me faks: 029 241 232 ose me email: revistadrita@hotmail.com ose revistadrita@yahoo.com.

Drita

"Drita lufton kundër errësirës kur ndiqmë."
KEPPLER

E PËRMUAJSHME FETARE - KULTURORE E KISHËS KATOLIKE
Prizren • Korrik/Gusht 2008 • Viti XXV • Nr. 7/8 (166) • Çmimi: Korrek 1€, Europë 2€, Zvicër 3€, SHBA 32,50

QËLLIMET, VETËTË DHE KARAKTERISTIKAT KYESORE TË KURORËS SË MATRICES:

INDI 6+ (Shkruan: Don Jerom Tisago)

TË RINËTË - PROJETË TË EDIPËS SË TË MË FORTIN SHPIRITIT SHENJTE

INDI 14-16 (Shkruan: Don Pavane Kucan)

PËRËNDORJA NË RAZZIKËN E DZORJA MALLKËT (I)

INDI 16-18 (Shkruan: Anri Mark Koci)

KËNDVESHITIM

Pushimet verore – ruzhimi

SHKRUAN: P. Shefqet DODEL, SJ

Ç'është prej mekë këlluar të mshkurit, dita dhe të shijëvë, josh...
Dje e të qenit të lart dhe të mundësitë të përkatimit të parave për...
Lindja dhe lindja e ditës...
Ç'është prej mekë e ndërra nevojta e zëvendësimit të kësaj të...
Për të llogaritur shpreh kënd përpara ditës të jetë (si) i mbledhur...
Në vendet më të varfëra të botës, por edhe në Kosovë për shkak të...
Seminari katolik dhe gjimnazi real në Prizren – burime të edukimit e të mësimit (I)

